



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

RAPORTI VJETOR

Janar – Dhjetor 2017



Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP

Prishtinë, Mars 2018

Rruga Luan Haradinaj "Ndërtesa e ish Bankës së Lubjanës kati –I-, 10000 Prishtinë

info@pzap-ks.org, www.pzap-ks.org 038/211-242

Përmbajtja

LISTA E SHKURTESAVE	5
VIZIONI DHE MISIONI.....	6
Vizioni.....	6
Misioni.....	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
TAKIMET/MBLEDHJET E PZAP-IT	16
STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE BURIMET NJERËZORE TË PZAP-IT	17
SEKRETARIATI I PZAP-IT.....	18
Struktura organizative e Sekretariatit.....	18
Objektivat e Sekretariatit të PZAP-it të realizuara/përmbushura gjatë vitit 2017	18
Publikimet e Sekretariatit të PZAP-it në Ueb faqen e tij.....	19
ORGANOGRAMI I PZAP-it.....	20
PUNËTORITË, TRAJNIMET DHE VIZITAT ZYRTARE JASHTË VENDIT	21
Punëtoritë e PZAP-it.....	21
Trajnimet e PZAP-it	22
Vizitat zyrtare jashtë vendit	25
Aktiviteti i Grupit punues për hartimin e Buletinit të PZAP-it	26
DEPARTAMENTI LIGJOR.....	27
Aktivitetet lidhur me çështjet e personelit të Sekretariatit të PZAP-it.....	28
Aktivitetet e prokurimit për nevoja të PZAP-it	30
BASHKËPUNIMI I PZAP-IT ME AKTERET E ZGJEDHJEVE	31
Bashkëpunimi i PZAP-it me KQZ-në	31
Bashkëpunimi i PZAP-it me Zyrën e Prokurorit të Shtetit.....	32
Bashkëpunimi i PZAP-it me Policinë e Kosovës.....	33
Bashkëpunimi me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian – OSBE	33
Bashkëpunimi i PZAP-it me Fondacionin Ndërkombëtarë për Sisteme Zgjedhore - IFES.....	34
TRANSPARENCA - KOMUNIKIMI DHE INFORMIMI PUBLIK.....	35
Transparenca me Misionin e Bashkimit Evropian në Kosovë për Vëzhgimin e Zgjedhjeve - MBEVZ..	35
Komunikimi me media dhe me publikun	35
SHPERNDARJA E FORMULAREVE TË ANKESAVE:.....	39

ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PËR KUVEND TË KOSOVËS TË MBAJTURA ME 11 QERSHOR 2017	40
REGJISTRIMI – VENDOSJA DHE ARKIVIMI I ANKESAVE/APELEVE PËR PROCESIN E ZGJEDHJEVE të 11 QERSHORIT 2017.....	40
Ankesat e hetuara në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve - QNR – KQZ.....	43
Ankesat/Apelet e paraqitura ndaj vendimeve të PZAP-it në Gjykatën Supreme të Kosovës:.....	43
Rastet e dorëzuara në Zyrën e Prokurorit të Shtetit.....	53
ZGJEDHJET LOKALE TË MBAJTURA ME 22 TETOR 2017	55
REGJISTRIMI – VENDOSJA DHE ARKIVIMI I ANKESAVE/APELEVE PËR PROCESIN E ZGJEDHJEVE TË 22 TETORIT 2017	55
DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME	68
PLANIFIKIMI I BUXHETIT DHE SHPENZIMEVE VJETORE PËR VITIN FISKAL - 2017	68
BUXHETI I PLANIFIKUAR DHE APROVUAR PËR VITIN – 2017	68
BUXHETI I SHPENZUAR PËR VITIN 2017	71
Paga dhe mëditjet	72
Mallra dhe shërbime	74
TË HYRAT E PZAP-IT.....	77
NJËSIA E TEKNOLOGJISË INFORMATIVE DHE LOGJISTIKËS	85
NJËSIA E PËRKTHIMEVE.....	86
NJËSIA E TRANSPORTIT.....	87
PËRFUNDIME	88
SFIDAT	89

LISTA E SHKURTESAVE

PZAP – Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

SPZAP – Sekretariati i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

KQZ – Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

KGJK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës

KPK – Këshilli Prokurorial i Kosovës

PK – Policia e Kosovës

MF - Ministria e Financave

MAP – Ministria e Administratës Publike

OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian

IFES – Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore

LZP – Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme

LZL – Ligji për Zgjedhjet Lokale

ZRPPC - Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim

SP- Subjektet Politike

KP – Kandidat i Pavarur

QNR – Qendra për Numërimin e Rezultateve

SIMFK – Sistemi Informativ për Menaxhmin e Financave të Kosovës

SIMBNJ – Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore – MAP

SIMR – Sistemi Informativ i Menaxhimit të Rasteve

NJQH - Njësia Qendrore Harmonizuese

ZAP - Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

KRPP – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik

DASHC – Departamenti i Administratës së Shërbimit Civil

VIZIONI DHE MISIONI

Vizioni

PZAP-i është dhe synon të jete një institucioni i besueshëm, i qëndrueshëm, i fuqizuar dhe inovativ që bashkëpunon për forcimin e drejtësisë zgjedhore.

Misioni

PZAP-i me qëllim të fuqizimit të demokracisë, është i përkushtuar që me profesionalizëm, paanshmëri dhe me kohë të zgjidhë kontestet zgjedhore për të siguruar të drejtat për të gjithë akteret lidhur me procesin zgjedhor.

PZAP është i përkushtuar për përmbushjen me besnikëri të detyrave në përputhshmëri me kushtetutën dhe ligjet e Kosovës. Të gjitha vendimet i merr në baza etike duke u bazuar në të gjitha provat për të promovuar besimin publik në aktivitetet e tij në përputhshmëri me ligjin, të pa ndikuara nga jashtë. Është i hapur dhe është përgjegjës për veprimtarinë që zhvillon si dhe siguron qasje për marrjen e informatave për të gjitha palët e interesuara.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti vjetor i punës pasqyron aktivitetet e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) gjatë vitit 2017, në veçanti pasqyron punën dhe rezultatet e arritura të departamenteve dhe të njësive tjera të administratës së sekretariatit si dhe punën e panelit në vendosjen e ankesave dhe apeleve për dy proceset zgjedhore të vitit 2017, ato të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtura me 11 Qershor 2017 dhe të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura 22 Tetor 2017. Raporti përmban të dhëna statistikore përkitazi me numrin e ankesave dhe apeleve të pranuar dhe të vendosura gjatë dy proceseve zgjedhore të vitit 2017, seancat e mbajtura, natyrën e ankesave, sanksionet e shqiptuara nga PZAP-i ndaj subjekteve politike, sanksionet e shqiptuara ndaj anëtarëve të Trupave Menaxhuese të Zgjedhjeve, shpenzimet buxhetore, aktivitetet e prokurimit, numrin e përgjithshëm e të punësuarve në PZAP. Raporti gjithashtu përmban të dhëna për pjesëmarrjen e anëtarëve të PZAP-it dhe stafit të sekretariatit në konferencat dhe punëtoritë e organizuara, vizitat e realizuara në vend dhe jashtë vendit dhe në trajnime të organizuara nga PZAP-i.

Të dhënat e paraqitura në raportin vjetor, janë dëshmi e punës së kryer me përkushtim dhe profesionalizmit nga ana e kryesueses dhe anëtarëve të PZAP-it, stafit të administratës të sekretariatit që njëherësh do të janë motiv shtesë për angazhim të mëtutjeshëm në tejkalimin e sfidave në proceset e ardhshme zgjedhore nga PZAP-i.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa punën e tij e ka përqendruar në drejtim të përmbushjes së objektivave të planifikuara me Planin Vjetor të Punës për vitin 2017, dhe të objektivave të planifikuara me Planin Strategjik të PZAP-it për periudhën 2016 – 2019, si dhe ka kryer punë dhe aktivitete të tjera të cilat nuk kanë qenë të planifikuara me Planin Vjetor të Punës së PZAP-it për vitin 2017, siç ishin Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura me 11 Qershor 2017.

PZAP-i, gjatë vitit 2017, ka pranuar dhe vendosur për 421 ankesa dhe apele të cilat janë parashtruar në PZAP për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtura me datën 11 Qershor 2017, dhe ka pranuar dhe vendosur për 1142 ankesa dhe apele për të dy raundet e Zgjedhjeve Lokale të mbajtura me datën 22 Tetor 2017, dhe për përsëritjen e votimit të raundit të parë për Kryetar të Komunës së Parteshit dhe për përsëritjen e votimit për raundin e dytë të zgjedhjeve për Kryetar të Komunës së Istogut. PZAP-i, vendimet e tij lidhur me ankesat dhe apelet e parashtruara për të dy proceset zgjedhore i ka publikuar në ueb faqen e PZAP-it, dhe vendimet në kopje fizike ju ka dorëzuar palëve.

Në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtura me 11 Qershor 2017 nga rastet më të rëndësishme që u shqyrtuan, veçojmë apelin **Anr.21/2017 i datës 30.05.2017**, të

Koalicionit SDA-BSDAK paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me nr. 769/2017 të datës 29.05.2017, për shkak të largimit nga lista e kandidatëve shqiptar të propozuar për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Koalicioni SDA-BSDAK, në PZAP ka paraqitur apel kundër vendimit të KQZ-së me nr. 769/2017 të datës 29.05.2017, me të cilin vendim, sipas parashtruesit të apelit, janë larguar nga lista 10 kandidat për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të koalicionit SDA-BSDAK, për shkak se janë të etnisë shqiptare.

Paneli i PZAP-it, ka vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të KQZ-së, nr. 769/2017 të datës 29.05.2017, dhe ka konstatuar se i njëjti është në harmoni të plotë me nenin 111 par.1 të LZP-së, në të cilin përcaktohet se: *“Vendet në Kuvend ndahen sipas sistemit të përfaqësimit të caktuar nga neni 64 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke ndarë:*

a) *njëqind (100) vende midis të gjitha subjekteve politike të certifikuara në raport me numrin e votave të vlefshme që kanë marrë ato; dhe*

b) *njëzet (20) vende janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë, si vijon:*

(i) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin serb, do të kenë numrin e vendeve në Kuvend të fituar në zgjedhjet e hapura, me minimumin dhjetë (10) vende të garantuara, në rast se numri i vendeve të fituara është më i vogël se dhjetë (10); (ii) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet e tjera, në Kuvend do të kenë numrin e vendeve të fituara në zgjedhjet e hapura me minimumin e vendeve të garantuara si në vijim: komuniteti rom një (1) vend; komuniteti ashkali një (1) vend; komuniteti egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë i jepet komunitetit rom, ashkali, ose egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komuniteti boshnjak tri (3) vende, komuniteti turk dy (2) vende dhe komuniteti goran një (1) vend, nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara”.

Prandaj paneli ka konsideruar se në momentin kur një subjekt politik që garon në zgjedhje, për vendet e garantuar, për përfaqësim të komuniteteve në Kuvendin e Kosovës, fillimisht specifikohet se cilit komunitet i takon subjekti politik që garon në zgjedhje dhe nëse subjekti politik dëshiron të garoj për vendet e garantuara në Kuvendin e Kosovës, është i njoftuar paraprakisht, me dispozitën e lart cituar ligjore dhe po ashtu në këtë rast është njoftuar nga KQZ me procedurën e aplikimit për regjistrim-certifikim, të cilën e potencon vetë udhëheqësi i

koalicioni SDA-BSDAK, se ka qenë i njoftuar me procedurën, në seancën e datës 26.05.2017, sepse rrjedhimisht kandidatët në listën e subjektit politik do të duhej të deklarohen me rastin e aplikimit për certifikim se garojnë për vendet e garantuar dhe duhet të jenë nga komuniteti jo shqiptar, pasi që në rastin konkret kemi të bëjmë koalicioni SDA-BSDAK, që ka garuar në zgjedhjet e datës 11.06.2017, për vendet e garantuara, për komunitetet jo shumicë në Kosovë.

Mbi këtë bazë paneli ka vlerësuar se KQZ me vendimin Nr. 769/2017 të datës 29.05.2017, drejt ka vepruar me rastin e largimit të kandidatëve shqiptar nga lista e koalicioni SDA-BSDAK, pasi që koalicioni SDA-BSDAK, ka garuar në Kuvendin e Kosovës për zgjedhjet e datës 11.06.2017, për vendet e garantuar, të cilat vendet si me nenin 64 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ashtu edhe me nenin 111 par. 1 të LZP-së, janë vende ekskluzivisht të rezervuara-garantuara për komunitet në Republikën e Kosovës, jo për komunitetin shqiptar, për këtë arsye dhe bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore, të gjitha subjektet politike që garojnë në zgjedhje për Kuvend të Republikës së Kosovës, për vendet e garantuara do të duhej që në listat e tyre për kandidat, për deputet të jenë vetëm nga komuniteti që i përket subjekti politik, jo nga komuniteti shqiptar, që në rastin konkret koalicioni SDA-BSDAK, nuk ka vepruar konform dispozitave të lartë theksuara dhe procedurave për aplikim të një subjekti politik që garon në zgjedhje për vendet e garantuar në Kuvend të Republikës së Kosovës, ku në mesin e kandidatëve për deputet ka propozuar për certifikim në KQZ edhe kandidat për deputet nga komunitetit shumicë-shqiptar në vend, i cili fakt nuk është kontestuar me pretendimet ankimore, se kandidatët e refuzuar për certifikim i përkasin komunitetit shumicë.

PZAP-i apelin Anr.21/2017 të datës 30.05.2017, të Koalicionit SDA-BSDAK paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me nr. 769/2017 të datës 29.05.2017, e ka refuzuar si të pabazuar për faktet dhe argumentet e theksuara me lartë me ç'rast kandidatet e propozuar për deputet të nacionalitetit shqiptarë nuk janë certifikuar si kandidate në listën e kandidateve për deputet të Koalicionit SDA-BSDAK për Kuvend të Kosovës.

Subjekti politik Koalicioni SDA-BSDAK ka apeluar Vendimin e PZAP-it Anr.21/2017 të datës 30.05.2017 në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes ankesës A.A. U.zh. nr. 3/2017 të datës 05.06.2017 me të cilën ka kundërshtuar ligjshmërinë e vendimit të kundërshtuar të PZAP-it.

Gjykata Supreme ka refuzuar si të pabazuar ankesën e subjektit politik Koalicioni SDA-BSDAK, pasi që PZAP-i ka vërtetuar gjendjen faktike plotësisht dhe drejt, dhe ka aplikuar drejt ligjin kur ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ushtruar nga subjekti politik Koalicioni SDA-BSDAK, kundër vendimit të KQZ-së nr.769/2017 të datës 29.05.2017, i cili vendim ka të

bëjë me mosmiratimin e certifikimit të 10 kandidatë nga subjekti politik Koalicioni SDA-BSDAK për zgjedhjet parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Rasti tjetër i rëndësishëm ishte ankesa **Anr.120/2017 më datën 08.06.2017**, e parashtruar nga Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova kundër subjektit politik Lista Serbe e cila ka publikuar një spot zgjedhor ku bënë mesazhe kërcënuese për mos krijimin e ushtrisë së Kosovës dhe funksionalizimin e plotë të shtetit të Kosovës. Në spot gjithashtu bëhet thirrje për ruajtje e institucioneve të Serbisë në Kosovë ndërsa Kosova quhet Kosova dhe Metohi. Spoti i Listës Serbe ka mesazhe që nxisin provokim dhe urrejtje ndaj ekzistencës të shtetit të Kosovës dhe janë në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova, është aprovuar nga PZAP-i dhe subjektit politik Lista Serbe, i është shqiptuar dënimi më gjobë në vlerë prej 25,000.00 (njëzet e pesë mijë) euro. PZAP-i ka vlerësuar se subjekti politik i lartpërmendur ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika (l) të LZP-së, e cila dispozitë ligjore përcakton: Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, subjektit politik, mbështetësve ose kandidatëve të tyre ju ndalohet përdorimi i gjuhës në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokoj një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë.

Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi mori parasysh shkeljet e lartpërmendura, dhe shqiptoj gjobën, duke u bazuar në nenin 120 par. 1 pika (c) LZP-së, nenin 3 pika 11 Rregullores Nr.01/2012, për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobjave të PZAP-it.

Vendimi i PZAP-it lidhur me këtë rast është apeluar nga Lista Serbe në Gjykatën Supreme të Kosovës të cilin vendim të PZAP-it Gjykata e ka vërtetuar, respektivisht e ka refuzuar ankesën e subjektit politik Lista Serbe.

Ne Zgjedhjet Lokale të mbajtura me 22 Tetor 2017 nga rastet më të rëndësishme që u shqyrtuan nga Paneli i PZAP-it veçojmë Apelin **Anr. 18/2017 i datës 15.09.2017**, për anulimin e vendimit Nr. 1623-2017 të datës 12.09.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me të cilin, parashtruesi i apelit, Zafir Berisha, është decertifikuar si kandidat për kryetar të Komunës së Prizrenit, nga subjekti politik NISMA.

Parashtruesi i apelit ka kërkuar nga PZAP-i që të anulohet vendimi Nr.1623-2017 i datës 12.09.2017 të KQZ-së, lidhur me decertifikimin e tij nga gara si kandidat për kryetar të Kuvendit Komunal në Prizren nga subjekti politik NISMA, pasi që i njëjti pretendon, se KQZ ka shkelur dispozitat e Kushtetutës që kanë të bëjnë me të drejtën zgjedhore dhe të pjesëmarrjes, si dhe ka bërë vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike.

Paneli ka konstatuar se KQZ-ja, me rastin e marrjes së vendimit Nr. 1623-2017 datë 12.09.2017, drejt ka zbatuar dispozitën ligjore të nenit 29 par. 4 të LZP-së, pasi që i njëjti është shpallur fajtor për veprë penale me aktgjykim përfundimtar në tri (3) vitet e fundit, sipas aktgjykimit, P.nr 504/14 të datës 20.08.2015 të Gjykatës Themelore në Prizren, është bërë i plotfuqishëm me datën 12.10.2015. Mbi këtë bazë vendimi i KQZ-së, për decertifikimin e apeluarit dhe largimin e tij nga lista e kandidatëve të subjektit politik, është i ligjshëm dhe çdo pretendim në apel mbi këtë bazë është i paqëndrueshëm.

Paneli me rastin e vendosjes mori parasysh edhe dispozitën e nenit 45 par.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në të cilin përcaktohet se: “Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën 18 vjeç, qoftë edhe në ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor”. Kjo e drejtë e garantuar me kushtetutë, parashtruesit të apelit nuk ju është kufizuar me vendimin e ankimuar të KQZ-së, pasi që pikërisht me nenin 55 par.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është përcaktuar se: “Te drejtat dhe liritë themelore të garantuar me këtë Kushtetutë mund të kufizohen vetëm me ligj”. Ndërsa, në rastin konkret kjo e drejtë parashtruesit të apelit për tu zgjedhur iu është kufizuar me nenin 29 par.4, të LZP-së, pasi që parashtruesi i apelit e ka humbur aftësinë për të qenë kandidat sipas nenin 29 par.1 pika q), të LZP-së.

Sipas vlerësimit të panelit edhe përmbajtja e dispozitës së nenit 45 të Kushtetutës, “gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor” është komentuar, në komentin e Gjykatës Kushtetuese, në këtë rast kemi të bëjmë me formën e dytë të mbrojtjes gjyqësore të kësaj të drejte, në kuptimin që Kushtetuta në këtë paragraf të nenit 45 paraqet prezumime për vendosjen e disa shkallëve dhe të formave të mbrojtjes së kësaj të drejte, e cila më vonë rregullohet me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë. Në vështrim të këtij Ligji, shkalla e parë dhe forma e mbrojtjes së kësaj të drejte është mbrojtja administrative brenda Komisionit Qendror Zgjedhor (neni 64 lidhur me nenin 98); e dyta është në PZAP si institucion i përhershëm dhe i pavarur në përbërje prej gjyqtarëve (115;118-119), ndërsa e treta është mbrojtja e plotë gjyqësore në Gjykatën Supreme të Kosovës (neni 118.4)”. Nga kjo rezulton se mbrojtja e të drejtës gjyqësore e garantuar me Kushtetutë konsumohet me vendimin e PZAP-së dhe mundësinë që i njëjti të ankimohet në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës.

Vendimi i PZAP-it Anr. 18/2017 i datës 15.09.2017 lidhur me këtë rast është apeluar në Gjykatën Supreme të Kosovës të cilin vendim të PZAP-it Gjykata e ka anuluar bashke me vendimin Nr.1623-2017 i datës 12.09.2017 të KQZ-së dhe me Aktgjykimin AA-Uzh.nr. 16/2017 të datës 20.09.2017 Gjykata Supreme e Kosovës ka miratuar apelin e Zafir Berishës nga subjekti politik Nisma për Kosovën (NISMA) kandidat për kryetar të Komunës së Prizrenit si dhe ka urdhëruar KQZ-në që të bëjë certifikimin e kandidatit Zafir Berisha nga subjekti politik Nisma për Kosovën (NISMA) për Zgjedhjet Lokale të datës 22 Tetor 2017. Nga ky aktgjykim kanë përfituar të gjithë kandidatet për anëtarë të kuvendeve komunale që janë de certifikuar nga KQZ dhe PZAP-i, të cilët me këtë aktgjykim janë certifikuar dhe kanë marrë pjesë në Zgjedhjet Lokale të 22 Tetorit 2017.

Rast tjetër i rëndësishëm ishte Apeli ZL.Anr 560/2017, i datës 01.11.2017 i kandidatit për kryetar të Komunës në Partesh, Nenad Cvetkovic nga radhët e subjektit politik GI Narodna Sloga. ***Paneli i PZAP-i apelin e ka shqyrtuar dhe ka vendosur që të anulohen rezultatet e Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10.2017, vetëm për kryetar Komune, në Qendrën e Votimit (QV) 3601d Budrigë e Poshtme, QV3602d Partesh dhe në QV3603d Pasjan, të gjitha në Komunën e Parteshit, për shkak të minimit të integritetit të zgjedhjeve si rezultat i shpërblimit financiar me qëllim të përfitimit të mbështetjes së votuesve si dhe ka Urdhëruar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) ta përsërisë votimin vetëm për kryetar komune në Qendrën e Votimit (QV) 3601d Budrigë e Poshtme, QV3602d Partesh dhe në QV3603d Pasjan, të gjitha në Komunën e Parteshit.***

Në këtë rast paneli i PZAP-it ka vlerësuar se vetë fakti i kontaktimit të drejtpërdrejtë i një kandidati për kryetar komune, siç është në këtë rast Dragan Petković, me një përfaqësues të një këmbimoreje, dhe nga i cili kërkon që t'i shpërblej votuesit me nga 30 euro apo 50 euro, e të cilat mjete vetë kandidati i premtonte shpërblyesit se do t'ia kthen gjatë mandatit katër vjeçar, rezulton se ka pas ndikim në rezultatin përfundimtar aq me shumë kur kemi të bëjmë me një komunë e cila përbëhet vetëm prej tri qendrave të votimeve, e të cilat parregullsi nuk janë eliminuar nga KQZ-ja edhe pse e njëjta ka qenë e njoftuar publikisht përmes RTK-së, me rastin e shpalljes së rezultateve për kryetar të komunave, për zgjedhjet lokale të datës 22 Tetorit 2017.

Vendimi i PZAP-it lidhur me këtë rast është apeluar nga Lista Serbe në Gjykatën Supreme të Kosovës të cilin vendim të PZAP-it Gjykata e ka vërtetuar, respektivisht e ka refuzuar si të pabazuar ankesën subjektit politik Srpska Lista, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës ZL.Anr.560/2017 të datës 02.11.2017.

Rast tjetër i rëndësishëm ishte Ankesa **ZL.Anr.1114/2017, e datës 24.11.2017** e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me të cilën pretendon se ka pasur shkelje në procesin e votimit me postë, sepse numri i votuesve me postë për Komunën e Istogut, është tejet i lartë ngase 58% e votave me postë në nivel të Kosovës, janë vetëm për Komunën e Istogut. Këto fletëvotime me postë janë në pliko të njëjta, fletëvotime të printuara të gjitha njëjtë, të dërguara me postën e njëjtë dhe për të njëjtin kandidat (Gani Dreshaj – AAK 99% të votave me postë, Haki Rugova – LDK, 1%). Më tej parashtruesi i ankesës pretendon se qytetarëve të shumtë i është vjedhur identiteti me rastin e aplikimit si votues jashtë Kosove, duke ua keqpërdorur të dhënat personale dhe duke aplikuar dhe votuar në emër të tyre, ndërsa të njëjtit janë banorë të përhershëm të Istogut, të cilët meqë janë larguar nga Lista Përfundimtare e Votuesve në Komunën e Istogut, janë detyruar që personalisht të votojnë me kusht në vendvotim, ka pasur votim në emër të qytetarëve të vdekur, votim të qytetarëve (kryesisht të komuniteteve pakicë) që jetojnë në vende të ndryshme të Evropës, por që në emër të të cilëve është votuar, kryesisht nga Mali i Zi, Sllovenia dhe Austria. Me propozim për panelin që të anulohet në tërësi procesi i votimit përmes postës për Komunën e Istogut, si dhe rezultati i votave me postë për secilin kandidat për Komunën e Istogut të përjashtohet nga rezultati përfundimtarë i zgjedhjeve për Kryetar të Komunës së Istogut.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së ka vendosur që të Anulohen rezultatet e Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10.2017, për Rundin e dytë, të mbajtura me datë 19.11.2017, për kryetar të Komunës në Istog dhe ka Urdhëruar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), që ta përsërisë votimin e Rundit e dytë të Zgjedhjeve Lokale, për Kryetar të Komunës së Istogut.

Vendimi i PZAP-it lidhur me këtë rast është apeluar nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në Gjykatën Supreme të Kosovës të cilin vendim të PZAP-it Gjykata e ka vërtetuar, respektivisht i ka refuzuar si të pathemelta ankesat e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia ZL.Anr.1114/2017, e datës 24.11.2017.

Korniza Ligjore – Emërimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Ne bazë të nenit 115 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme – LZP-së, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) është organ i përhershëm i pavarur kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është caktuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) dhe Rregullat Zgjedhore.

Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës emëron kryesuesin e PZAP-it nga mesi i gjykatësve të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe emëron anëtarët nga mesi i gjykatësve të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore të Kosovës që nënkupton së marrëdhënia e punës e anëtarëve të PZAP-it përfshi kryesuesin, funksionin në PZAP sipas LZP-së e kanë mandat shtesë.

Anëtarët dhe kryesuesi i PZAP-it kane mandat katër (4) vjeçar.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa përbëhet nga dhjetë anëtarë përfshi kryesuesen:

1. Gyltene Sylejmani, Kryesuese e PZAP-it/Gjyqtare e Gjykatës Supreme të Kosovës;
2. Hasan Shala, anëtarë i PZAP-it/Kryetar i Gjykatës së Apelit-Prishtinë;
3. Ymer Hoxha, anëtarë i PZAP-it/Kryetar i Gjykatës Themelore-Prizren;
4. Rafet Haxhaj, anëtarë i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës së Apelit – Prishtinë;
5. Nenad Laziq, anëtarë i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës së Apelit-Prishtinë;
6. Fejzullah Rexhepi, anëtarë i PZAP-it/Gjyqtarë i Gjykatës se Apelit - Prishtinë;
7. Zyhdi Haziri, anëtarë i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës Themelore-Gjilan;
8. Afijete Sada, anëtare e PZAP-it/Gjyqtare e Gjykatës Themelore-Gjakovë;
9. Faton Ademi, anëtarë i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës Themelore – Mitrovicë;
10. Adnan Konushevc, anëtarë i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës Themelore – Prishtinë.



Gyltene Sylejmani,
kryesuese



Hasan Shala,
anëtar



Ymer Hoxha,
anëtar



Rafet Haxhaj,
anëtar



Nenad Lazić,
anëtar



Fejzullah Rexhepi,
anëtar



Zyhdi Haziri,
anëtar



Afijete Sada-Gllogjani,
anëtare



Faton Ademi,
anëtar



Adnan Konushevci,
anëtar

TAKIMET/MBLEDHJET E PZAP-IT

PZAP-i gjatë vitit 2017 ka mbajtur nëntë (9) takime/mbledhje të rregullta mujore në të cilat takime janë shqyrtuar, diskutuar dhe janë marrë vendime që kane të bëjnë me çështjet e administrative të ndërlidhura me funksionimin e PZAP-it. Vendimet më kryesore ishin:

- Aprovimi i Raportit Vjetor të Punës së PZAP-it për vitin 2016,
- Aprovimi i Vendimeve të PZAP-it për mbajtjen e dy punëtorive në Durrës e para nga data 23 - 26 Mars 2017 dhe e dyta nga data 07 – 10 Shtator 2017,
- Aprovimi i dy vendimeve të Planit të Veprimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura me 11 Qershor 2017 dhe Planit të Veprimit për Zgjedhjet Lokale të mbajtura me 22 Tetor 2017,
- Aprovimi i dy vendimeve për pagesën e shtesave për angazhime shtesë gjatë dhe pas orarit të punës për anëtarët e PZAP-it përfshi kryesuesen e PZAP-it si dhe të zyrtarëve të sekretariatit të PZAP-it për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura me 11 Qershor 2017 dhe Zgjedhjet Lokale të mbajtura me 22 Tetor 2017,
- Aprovimi i dy vendimeve për Zgjatjen e Orarit të Punës për stafin e sekretariatit të PZAP-it për Zgjedhjet për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura me 11 Qershor 2017 dhe Zgjedhjet Lokale të mbajtura me 22 Tetor 2017,
- Aprovimi i Vendimeve për rekrutimin e zyrtarëve të përkohshëm në Sekretariatin e PZAP-it për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura me 11 Qershor 2017 dhe Zgjedhjet Lokale të mbajtura me 22 tetor 2017 të cilët kanë punuar prej emërimit të tyre në bazë të Marrëveshjes mbi Shërbimet e Veçanta – MSHV deri 15 ditë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.


STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE BURIMET NJERËZORE TË PZAP-IT

Struktura organizative e Institucionit të PZAP-it, përbëhet nga anëtarët e PZAP-it përfshi kryesuesin, si trup vendimmarrës profesional, dhe nga Sekretariati i tij i cili mbështetë punën e PZAP-it në përmbushjen e funksioneve dhe përgjegjësi të tij të përcaktuara me LZP.

Me buxhetin e propozuar për vitin 2017 dhe i cili është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, PZAP-i ka të lejuara 20 pozita, prej tyre: 1 (një) Kryesues të PZAP-it, 9 (nëntë) anëtarë të panelit të PZAP-it, 1 (një) Kryesues të Sekretariatit të PZAP-it dhe 9 (nëntë) zyrtarë të sekretariatit të PZAP-it.

Numri i përgjithshëm i anëtarëve të PZAP-it përfshi kryesuesin është dhjetë (10), prej tyre tetë (8) janë të gjinisë mashkullore ose 80% ndërsa dy (2) janë të gjinisë femërore ose 20%, kurse sa i përket përkatësisë nacionale nëntë (9) janë shqiptarë ose 90% ndërsa një (1) anëtarë është i përkatësisë serbe, ose 10%.

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në Sekretariatit e PZAP-it është 9 veta, prej tyre pese (5) janë të gjinisë mashkullore ose 55% ndërsa 4 janë të gjinisë femërore ose 45%, kurse sa i përket përkatësisë nacionale tetë (8) janë shqiptarë ose 89% ndërsa një (1) i punësuar është i përkatësisë boshnjake, ose 11%.



SEKRETARIATI I PZAP-IT

Sekretariati i PZAP-it, udhëhiqet nga Kryesuesi i Sekretariatit i cili nën drejtimin e kryesuesit të PZAP-it në bazë të nenit 123.4 të LZP-së është përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e Sekretariatit për të gjitha çështjet administrative të ndërlidhura me funksionimin e PZAP-it.

Struktura organizative e Sekretariatit

- Zyra e Kryesuesit të sekretariatit, të cilën e përbejnë Kryesuesi dhe Asistentja Ekzekutive,
- Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme, i cili përbëhet nga Drejtori i Departamentit, Zyrtari i Përkthimeve Shqip-Serbisht dhe anasjelltas, Zyrtari për Administrimin e Teknologjisë Informative dhe Logjistikë, dhe Zyrtari i Transportit.
- Departamenti Ligjorë i cili përbëhet nga Drejtori i Departamentit dhe tre Zyrtarë të Lartë Ligjorë.

Objektivat e Sekretariatit të PZAP-it të realizuara/përmbushura gjatë vitit 2017

- Plani Strategjik i PZAP-it 2016 – 2019,
- Plani Vjetor i Punës së PZAP-it për vitin 2017
- Plani i Veprimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtura më 11 Qershor 2017 si dhe Plani i veprimit për Zgjedhje Lokale të 22 Tetorit 2017.
- Vendimi për pagesën e shtesave për angazhime shtesë gjatë dhe pas orarit të punës për anëtarët e PZAP-it përfshi kryesuesen e PZAP-it si dhe të zyrtarëve të sekretariatit të PZAP-it për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura me 11 Qershor 2017 dhe Zgjedhjet Lokale të mbajtura me 22 Tetor 2017,
- Vendimi për Zgjatjen e Orarit të Punës për stafin sekretariatit të PZAP-it për Zgjedhjet për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura me 11 Qershor 2017 dhe Zgjedhjet Lokale të mbajtura me 22 Tetor 2017,
- Vendimi për rekrutimin e zyrtarëve të përkohshëm në Sekretariatin e PZAP-it për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura me 11 Qershor 2017 dhe Zgjedhjet Lokale të mbajtura me 22 Tetor 2017 të cilët kanë punuar prej emërimit të tyre në bazë të Marrëveshjes mbi Shërbimet e Veçanta – MSHV deri 15 ditë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.

- Sekretariati i PZAP-it ka regjistruar/futur të dhënat në Sistemin e Menaxhimit të Ankesave dhe Apeleve –SMAA për 421 ankesa dhe apele bashke me shkresat e lëndës, si dhe vendimet e Panelit të PZAP-it për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtura me 11 Qershor 2017, dhe vendimet lidhur me 1142 ankesa dhe apele bashke me shkresat e lëndës si dhe vendimet e Panelit të PZAP-it për Zgjedhjet Lokale të mbajtura me 22 Tetor 2017.

Publikimet e Sekretariatit të PZAP-it në Ueb faqen e tij


- Raporti vjetor për vitin 2016 në gjuhën shqipe dhe serbe;
- Vendimet lidhur me 421 ankesa dhe apele të paraqitura për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtura me 11 Qershor 2017 dhe vendimet lidhur me 1142 ankesa dhe apele të paraqitura për Zgjedhjet Lokale të mbajtura me 22 Tetor 2017 dhe
- Te gjitha dokumentet e rëndësishme të PZAP-it.

Sekretariati në takimet/mbledhjet e PZAP-it për të gjitha çështjet administrative të ndërlidhura me funksionimin e PZAP-it ka prezantuar:

- Raportet tremujore të punës së PZAP-it,
- Draft Raportin e punës së PZAP-it për vitin 2016,
- Planin e Veprimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të 11 Qershorit 2017,
- Planin e Veprimit për Zgjedhjet Lokale të 22 Tetorit 2017,
- Planin e punës për vitin 2018 etj..

Sekretariati i PZAP-it, për të gjitha takimet/mbledhjet e mbajtura nga PZAP-i ka përgatitur të gjitha materialet e nevojshme.

ORGANOGRAMI I PZAP-it



PUNËTORITË, TRAJNIMET DHE VIZITAT ZYRTARE JASHTË VENDIT

Punëtoritë e PZAP-it

Me qëllim të ngritjes dhe zhvillimit të vazhdueshëm të kapaciteteve të stafit, rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit në punë, PZAP-i gjatë vitit 2017 ka organizuar tri punëtori.

Punëtorja e parë e mbajtur nga data 23-26 Mars 2017

Punëtorja e parë është mbajtur në Durrës nga data 23-26 Mars 2017 në të cilën punëtori kanë marrë pjesë anëtarët e PZAP-it përfshi kryesuesen, personeli i sekretariatit të PZAP-it, ish-Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si dhe përfaqësuesit nga OSBE-ja dhe IFES-i. Në këtë punëtori janë diskutuar tema dhe çështje si më poshtë:

- Prezantimi i Raportit të punës së PZAP-it për vitin 2016,
- Finalizimi i Buletinit me vendime të PZAP-it për periudhën 2009 – 2016,
- Përgatitja dhe unifikimi i vendimeve të PZAP-it për zgjedhjet e ardhshme.

Punëtorja e dytë e mbajtur nga data 07-10 Shtator 2017:

Punëtorja e dytë është mbajtur në Durrës nga data 07-10 Shtator 2017 në të cilën punëtori kanë marrë pjesë anëtarët e PZAP-it përfshi kryesuesen, personeli i sekretariatit të PZAP-it, ish-Kryetari i Gjykatës Supreme, Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si dhe përfaqësuesit nga OSBE-ja dhe IFES-i. Në këtë punëtori janë diskutuar tema dhe çështje si më poshtë:

- Mësimet e nxëna nga Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe Përgatitja për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të 22 Tetorit 2017.
- Krahاسimi i procesit zgjedhor ankimor lidhur me periudhën para fushatës zgjedhore dhe gjatë fushatës zgjedhore, të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të vitit 2014 dhe 2017.
- Krahاسimi i procesit zgjedhor ankimor lidhur me heshtjen zgjedhore dhe ditën e zgjedhjeve, për Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të vitit 2014 dhe vitit 2017.
- Krahاسimi i procesit zgjedhor ankimor lidhur me administrimin dhe numërimin në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve-QNR, si dhe Certifikimi i Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të vitit 2014 dhe vitit 2017.
- Plani i Punës së PZAP-it për Zgjedhjet Lokale të 22 Tetorit 2017.

Punëtorja e tretë e mbajtur nga data 19-21 Dhjetor 2017:

Punëtorja e tretë është mbajtur në Durrës nga data 19-21 Dhjetor 2017 në të cilën punëtori kanë marrë pjesë anëtarët e PZAP-it përfshi kryesuesen, personeli i sekretariatit të PZAP-it, si dhe përfaqësuesit nga OSBE-ja dhe IFES-i. Në këtë punëtori janë diskutuar tema dhe çështje si më poshtë:

- Vlerësimi i përgjithshëm i performancës së PZAP-it për Zgjedhjet Lokale të 22 Tetorit 2017, Vlerësimi i çështjeve të zgjedhjeve (paraqitja e të dhënave statistikore të ankesave dhe apeleve të Zgjedhjeve Lokale 2017 si dhe të atyre të vitit 2013),
- Planifikimi, ndarja e buxhetit dhe realizimi i tij gjatë Zgjedhjeve Lokale 2017 si dhe të hyrat e realizuara nga gjobat e shqiptuara ndaj subjekteve politike,
- Vlerësimi i performancës së PZAP-it në komunikim me mediat dhe akteret tjerë gjatë Zgjedhjeve Lokale 2017,
- Vlerësimi i performancës së PZAP-it në përgatitjen dhe arsyetimin e vendimeve gjatë Zgjedhjeve Lokale 2017,
- Vlerësimi i performancës së PZAP-it në zbatimin e afateve ligjore në marrjen e vendimeve lidhur me ankesat dhe apelet për zgjedhjet lokale 2017.

Trajnimet e PZAP-it

PZAP-i me përkrahjen e Fondacionit Ndërkombëtarë për Sisteme Zgjedhore - IFES, gjatë vitit 2017 ka organizuar dhe mbajtur 12 trajnime, në të cilat trajnime kanë marrë pjesë të gjithë zyrtaret e Sekretariatit dhe disa nga anëtarët e PZAP-it, varësisht prej kohës se tyre dhe temave të trajnimit.

Në muajin Janar 2017 temat e trajnimeve kanë qenë:

- “Planifikimi Efektiv” i cili trajnim është mbajtur me datën 11 dhe 12 Janar 2017 në Prishtinë. Në këtë trajnim është diskutuar lidhur me rëndësinë planifikimit të punës, hartimin e tyre, mënyrat se si bëhet planifikimi, koston e tyre si dhe monitorimin dhe vlerësimin e tyre.
- “Komunikimi me media” i mbajtur nga data 23-24 Janar 2017 në Prishtinë. Në këtë trajnim është diskutuar lidhur me rëndësinë e komunikimit me media, organizimin e konferencave për shtyp, përgatitja e komunikatave të ndryshme, përgatitja e intervistave, menaxhimi i keq raportimeve në media, monitorimi i mediave.

Në muajin Shkurt 2017 temat e trajnimeve kanë qenë:

- “Hulumtime dhe Analizat”, të mbajtur me datën 09 dhe 10 Shkurt 2017 në Prishtinë, në të cilin trajnim u elaborua rëndësia e hulumtimit dhe metodat shkencore, mënyra e mbledhjes së të dhënave, puna me të dhëna, analizimi dhe vlerësimi i këtyre të dhënave.
- Me datën 22 dhe 23 Shkurt 2017 në Prishtinë është mbajtur trajnimi i radhës me temën “Proceset Zgjedhore në Kosovë” ku në këtë trajnim janë prezantuar zhvillimet e proceseve zgjedhore në Republikën e Kosovës, pastaj përgjegjësitë e aktereve gjatë proceseve zgjedhore, procesi i votimit dhe i numërimit të votave nder vite etj.

Në muajin Mars 2017 është mbajtur trajnimi me temën:

- “Pranimi i rasteve të ankesave në PZAP” i cili është mbajtur në Pejë nga data 15 deri më 16 Mars 2017, në të cilin trajnim është elaboruar lidhur me procedimin e ankesave, mënyra se si është proceduar në të kaluarën dhe si do të procedohet në të ardhmen, pastaj lidhur me kategorizimin e ankesave sipas fazave të procesit zgjedhor, dorëzimin e shkresave dhe komunikimi me palë në procedurë, procesi i hetimit të rasteve sipas pretendimeve ankimore etj. Po ashtu në këtë trajnim u prezantua edhe mënyra e funksionimit të sistemit për menaxhimin e rasteve (CAMS), rreth mirëmbajtjes së tij, përditësimi i të dhënave, pranimi i rasteve, regjistrimi i tyre etj.

Në muajin Prill 2017 temat e trajnimeve kanë qenë:

- “Hartimi i Planit për Menaxhim të Rrezikut” grupet e synuara për këtë trajnim ishin grupi punues i PZAP-it dhe Grupi punues i KQZ-së për hartimin e këtij plani menaxhues të rrezikut në kontest zgjedhor.
- “Shqyrtimi dhe Hetimi i Ankesave” i cili është mbajtur në Prishtinë më datë 12 Prill 2017, në të cilin trajnim grup i synuar ishin zyrtarët e sekretariatit të PZAP-it. Në këtë trajnim është bërë demonstrimi se si shqyrtohet dhe si bëhet hetimi i pretendimeve ankimore në parashtruara nga palët e interesuara si dhe
- Më datë 20 Prill 2017 në Prishtinë është mbajtur trajnimi me temën “Hartimi i Vendimeve Ligjore” në të cilin trajnim grup i synuar ishin zyrtarët e sekretariatit të PZAP-it, me qëllim të ngritjes së cilësisë gjatë përpilimit të vendimeve të ndryshme.

Në muajin Maj 2017 temat e trajnimeve kanë qenë:

- Në kuadër të trajnimeve të parapara në bazë të Planit të Trajnimeve më datë 11 dhe 12 Maj 2017 është mbajtur trajnimi me temë “Krahasimi i Proceseve të Ankesave Zgjedhore”
- Si dhe trajnimi i mbajtur më datë 26 Maj 2017 lidhur me mënyrën dhe funksionimin e sistemit për menaxhimin e rasteve (CAMS), me qëllim që zyrtarët e përkohshëm në sekretariatit të PZAP-it, të trajnohen rreth mirëmbajtjes së sistemit, përditësimit e të dhënave, pranimi të rasteve, regjistrimit e tyre etj.

Në muajin Korrik 2017 tema e trajnimit ka qenë:

- Më datë 31 Korrik dhe 01 gusht 2017 është mbajtur trajnimi me temën “Aftësitë për hartimin e pretendimeve ankimore” në të cilin trajnim grup i synuar ishin zyrtarët e përhershëm si dhe zyrtarët e përkohshëm të sekretariatit të PZAP-it. Në këtë trajnim është bërë demonstrimi se si të përpilohet një ankesë, dhe se cilat elemente duhet të përmbajë një pretendim ankimor i parashtruar nga palët.

Në muajin Gusht 2017 temat e trajnimeve kanë qenë:

- Më datë 29 Gusht është mbajtur trajnimi me temën “Aftësitë Prezantuese Para Publikut”, ky trajnim ka pasur për qëllim ngritjen e kapacitetit prezantues duke pasur parasysh faktin se në vitin 2017 janë mbajtur dy procese zgjedhore. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë anëtarët e PZAP-it, zyrtarët e përhershëm të sekretariatit të PZAP-it si dhe zyrtarët e përkohshëm të cilët kanë qenë të përfshirë në proceset zgjedhore në institucionin e PZAP-it.
- Si dhe trajnimi i mbajtur më datë 30-31 Gusht me temën “Aftësitë Trajnuese”, në të cilin kanë marrë pjesë vetëm zyrtarët e përhershëm dhe të përkohshëm të Sekretariatit të PZAP-it.

Vizitat zyrtare jashtë vendit

Vizita e delegacionit të PZAP-it në Maqedoni për vëzhgimin e Zgjedhjeve Lokale është realizuar nga data 13 Tetor 2017 deri me 16 Tetor 2017.

- Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP duke nisur përvoja e mire e bashkëpunimit që ka me Komisionin Shtetërorë të Zgjedhjeve – KSHZ të Maqedonisë ka dërguar kërkesën zyrtare në adresë të këtij komisioni për akreditimin e një delegacioni të PZAP-it për vëzhgimin e Zgjedhjeve Lokale të cilat janë mbajtur me 15 Tetor 2017.
- KSHZ të Maqedonisë sipas kërkesës së PZAP-it ka akredituar delegacionin e PZAP-it dhe i ka mundësuar atij që të vëzhgoj procesin zgjedhor në Maqedoni.
- Vizita e delegacionit të PZAP-it është realizuar nga data 13 Tetor 2017 deri me datën 16 Tetor 2017.
- Përbërja e delegacionit të PZAP-se ishte si në vijim: Gyltene Sylejmani – Kryesuese e PZAP-it, Anëtarët e PZAP-it: Hasan Shala, Fejzullah Rexhepi, Adnan Konushevci, Kryesues i Sekretariatit të PZAP-it Mulë Desku dhe Zyrtar i Transportit në Sekretariatin e PZAP-it Xhevdet Millaku.
- Delegacioni i PZAP-it në Shkup ka arritur me datën 13.10.2017 në ora 12:00 ndërsa nga ora 13:00 deri në ora 15:30 ka marrë pjesë në takimin e Komisionit Shtetërorë të Zgjedhjeve të Maqedonisë i cili është organizuar për vëzhguesit ndërkombëtar të zgjedhjeve. Vëzhguesve ndërkombëtar të zgjedhjeve në Maqedoni iu është adresuar me një fjale rasti Kryetari i Komisionit Shtetërorë të Zgjedhjeve Z. Aleksandar Cicakovski, i cili vëzhguesve iu ka uruar dhe dëshiruar mirëseardhje dhe i ka njoftuar me të gjitha përgatitjet e Komisionit Shtetërorë të Zgjedhjeve për Procesin e Zgjedhjeve Lokale.
- Ne cilësi të vëzhguesve ndërkombëtar përveç delegacionit të PZAP-it kane marr pjesë dhe vëzhgues nga Bullgaria, Mali i Zi etj..
- Gjatë qëndrimit në Maqedoni, delegacioni i PZAP-it bashke me vëzhguesit tjerë ndërkombëtar ju ka përmbajtur dhe ka përfillur një agjendë të caktuar nga KSHZ-ja e Maqedonisë për vëzhguesit ndërkombëtar. Ditën e shtunë, me datën 14.10.2017, janë vizituar disa vende historike të Maqedonisë. Me datën 15.10.2017, në ditën e zgjedhjeve, delegacioni nga mëngjesi deri në mbrëmje ka vizituar disa Qendra të Votimit për të përcjellë nga afër procesin e votimit të votuesve në këto qendra të votimit.

- Delegacioni i PZAP-it i Republikës së Kosovës është ndarë i kënaqur me praktikën e mirë që i ka vërejtur nga afër gjatë ditës së zgjedhjeve në Qendrat e Votimit, me shkëmbimin e informatave me trupat menaxhuese të zgjedhjeve në Vendvotime, si dhe shkëmbimi i përvojave profesionale dhe diskutimet që Kryesuesja e PZAP-it bashkë me anëtarët tjerë të delegacionit të PZAP-it ka pasur me Kryetarin e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve të Maqedonisë, Z. Aleksandar Cicakovski, me nënkryetarin Z. Rexhep Prekopuca, anëtarin e KSHZ-së, Z. Subhi Jakupi, dhe anëtarët tjerë të KSHZ-së.
- Këto përvoja dhe praktika të nxëna gjatë procesit zgjedhor në Maqedoni do të jenë shumë të mirëseardhura për PZAP-in në të ardhmen.

Aktiviteti i Grupit punues për hartimin e Buletinit të PZAP-it

Grupi punues për hartimin e buletinit të PZAP-it për periudhën e proceseve zgjedhore nga viti 2009 – 2016 ka mbajtur takimin e radhës me datë 15.02.2017, i cili kishte për qëllim finalizimin e Draft-Buletinit si dhe nga rekomandimet e dhëna më herët në këtë draft janë përfshirë edhe 17 vendimeve nga zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Glllogocit të mbajtura me datën 04 Dhjetor 2016.

Po ashtu në këtë takim është bërë përzgjedhja përfundimtare e vendimeve nga grupi punues, kështu që nga 61 vendime të propozuara më herët u vendosur që të mbeten 32 vendime për të gjitha fazat e procesit zgjedhor nga viti 2009 deri 2016. Nga ky takim si rekomandim doli që të gjitha vendimet të renditen sipas viteve duke filluar nga viti 2009 deri në vitin 2016, si dhe të bëhet ristrukturimi dhe dizajnimi i disa çështjeve teknike të buletinit.

DEPARTAMENTI LIGJOR

Aktivitetet e zyrtareve të Departamentit Ligjor kanë qenë si në vijim:

- Zyrtarët ligjorë kanë përgatitur raportet mujore të punës, lidhur me aktivitetet e kryera të zyrës ligjore të cilat janë prezantuar në takimet e rregullta të SPZAP-it,
- Identifikimi i vendimeve për Buletinin e PZAP-it 2009- 2016,
- Përgatitja e paralajmërimeve për gjobat e papaguara nga ana e subjekteve politike për Zgjedhjet e Glllogocit 2016, dhe për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare për Kuvend të Kosovës.
- Përgatitja e propozimeve për përmbarimin e vendimeve me gjoba të shqiptuara ndaj subjekteve politike gjatë procesit zgjedhor 2013-2014 dhe dorëzimi i tyre tek përmbaruesi privat.
- Identifikimi i vendimeve të PZAP-it nga zgjedhjet e kaluara me qëllim që anëtarët e panelit të bëjnë unifikimin e tyre për zgjedhjet e ardhshme.
- Shkëmbimi i informatave me ZRPPC-KQZ lidhur me të dhënat për subjektet politike dhe kandidatët e pavarur.
- Zyrtarët ligjorë kanë marrë pjesë në takimet e rregullta të mbajtura me Sekretariatit dhe anëtarët e PZAP-it, si dhe në takimet e grupit punues për buletin.
- Zyrtarët ligjorë kanë bërë nxjerrjen e të dhënave statistikore lidhur me vendimet e shqiptuara me gjobë ndaj subjekteve politike për Zgjedhjet Lokale 2013 dhe ato Parlamentare 2014.
- Zyrtarët Ligjor kanë marrë pjesë në takimin e organizuar me Personat me Aftësi të Kufizuar, ku është diskutuar lidhur me përgatitjen e formularëve të ankesave në alfabetin brail me qëllim të inkurajimit të personave me aftësi të kufizuara për të marr pjesë në proceset zgjedhore
- Përgatitja e të dhënave me qëllim të njoftimit të KQZ-së lidhur me ruajtjen e materialit zgjedhor i cili mund të jete objekt hetimi nga Prokuroria e Shtetit për Zgjedhjet Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Glllogocit, dhe për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të 11 Qershorit 2017.
- Përgatitja e rasteve me elemente të veprave penale për Zgjedhjet Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Glllogocit, dhe për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës me qëllim të njoftimit me këto të dhëna Zyrën e Prokurorit të Shtetit.
- Pjesëmarrja e personit kontaktues të PZAP-it në takimin e organizuar nga Agjencioni Antikorrupcion (AAK) lidhur me procesin e rregullt të deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë të institucionit, njoftimin e zyrtarëve për deklarimin e rregullt të pasurisë nga ana e tyre, raportimi i institucionit për mospranimin e dhuratave nga ana e PZAP-it gjatë vitit 2017.

- Asistimi i zyrtareve ligjor në seanca dëgjimore për rastet e ankesave dhe apeleve gjate dy palë të zgjedhjeve të vitit 2017 kur paneli e ka përcaktuar si të nevojshme mbajtjen e tyre.
- Përgatitja e të gjitha materialeve të nevojshme për mbajtjen e seancave dhe marrjen e vendimeve nga paneli i PZAP-it lidhur me Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të 11 Qershorit 2017 dhe Zgjedhjet Lokale të mbajtura më 22 Tetor 2017.
- Futja e të dhënave në sistemin e menaxhimit të ankesave dhe apeleve që janë në përgjegjësi të zyrtarit ligjor.
- Pjesëmarrja e zyrtareve ligjor në hetimim e rasteve në QNR për shkeljet përkitazi me numërimin e rezultateve për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës dhe Zgjedhjet Lokale të vitit 2017.

Aktivitetet lidhur me çështjet e personelit të Sekretariatit të PZAP-it

- Duke u bazuar në Planin Vjetor të Punës dhe në Planin e Rekrutimit të PZAP-it për vitin 2017 është planifikuar shpallja e Konkursit për plotësimin e pozitës së Drejtorit të Departamentit ligjor dhe konkursit për rekrutimin e zyrtareve të përkohshëm për Zgjedhjet Lokale të vitit 2017.

Konkursi për Drejtor të Departamentit Ligjor

Procedura e Rekrutimit për Pozitën e Drejtorit të Departamentit Ligjor në sekretariatin e PZAP-it është zhvilluar deri në fazën e vlerësimit të testit me shkrim të një kandidati, por për arsye se ky kandidat nuk ka arritur numrin e mjaftueshëm të pikëve në testin me shkrim procedura nuk ka vazhduar, respektivisht është ndërprerë. Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil ka anuluar procesin e rekrutimit dhe ka planifikuar që të publikoj shpalljen e re. Shpallja e re nuk është publikuar për arsye të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtura me 11 Qershor 2017 dhe Zgjedhjeve Lokale të mbajtura më 22 Tetor 2017. KPSHCK është njoftuar me të gjitha dokumentet e procedurës së rekrutimit për këtë pozitë.

Konkursi për zyrtarë të përkohshëm të Sekretariatit gjatë zgjedhjeve

Me planin e rekrutimit të PZAP-it për vitin 2017 nuk është planifikuar shpallja e Konkursit për rekrutimin e zyrtareve të përkohshëm për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të cilat janë mbajtur me 11 Qershor 2017, por është planifikuar rekrutimi i zyrtareve të përkohshëm vetëm për Zgjedhjet Lokale të vitit 2017.

Për shkak të shpalljes së Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvend të Kosovës, PZAP-i ka vendosur që të shpallë konkursin për rekrutimin e zyrtareve të përkohshme për këto Zgjedhje.

- Konkursi për rekrutimin e zyrtarëve të përkohshme është shpallur me datën 17.05.2017 në Ueb Faqen e PZAP-it dhe në Tabelën e shpalljeve të PZAP-it dhe ka mbetur i hapur deri me datën 19.05.2017 ku edhe është mbajtur intervista për përzgjedhjen kandidatëve.
- Për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtura me 11 Qershor 2017 janë rekrutuar dhjetë (10) zyrtarë të përkohshëm, prej tyre 3 (tre) Zyrtarë Ligjor, 3 (tre) Asistentë Administrativ dhe 4 (katër) Futës i të dhënave në Sistemin Informativ të Rasteve.
- Kandidatët e përzgjedhur kanë filluar punën me datën 23.05.2017 sipas Marrëveshjes për Shërbime të Veçanta (MSHV) dhe kanë punuar deri 15 dite pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve me datën 24.07.2017.
- Për Zgjedhjet Lokale të 22 Tetorit 2017, për shkak të përvojës dhe vlerësimit pozitiv që kanë treguar zyrtaret e përkohshëm gjatë Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvend të Kosovës, janë angazhuar zyrtaret e njëjtë duke i shtuar edhe dy (2) zyrtarë ligjor të cilat kanë qenë në listën e pritjes nga procesi i rekrutimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës. Gjithsejtë për Zgjedhjet Lokale janë angazhuar dymbëdhjetë (12) zyrtarë të përkohshëm, prej tyre 5 (pesë) Zyrtarë Ligjor, 3 (tre) Asistent Administrativ dhe 4 (katër) Futës të dhënave në Sistemin Informativ të Rasteve.
- Në Zgjedhjet Lokale zyrtaret e përkohshëm kanë filluar punën me datën 01.08.2017 sipas Marrëveshjes për Shërbime të Veçanta MSHV, deri më 15 ditë pas certifikimit të rezultateve përfundimtare me datën 11 Janar 2018.
- Zyrtarët e përkohshëm të punësuar në sekretariatën e PZAP-it me përgjegjësi kanë kryer detyrat e caktuara në baze të përshkrimit të punës dhe në përputhje me LQP dhe Rregullat e Procedurat e PZAP-it si dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
- Sistemimi në dosje fizike dhe elektronike i formularëve të vlerësimit të personelit për vitin 2017, si dhe dorëzimi i tyre në DASHC/MAP.
- Dorëzimi i formularëve përmbledhës të vlerësimit të personelit në DASHC-MAP.
- Përgatitja dhe dorëzimi i planit të trajnimit për vitin 2017 në DASHC/MAP.
- Përgatitja e planit vjetor të pushimeve sipas planifikimit të personelit për vitin 2017, si dhe regjistrimi i tyre në SIMBNJ.
- Përditësimi, rregullimi i dosjeve personale të nëpunësve të SPZAP-it, në mënyrë fizike dhe elektronike në SIMBNJ.
- Përgatitja e kërkesës për pushime për personelin e SPZAP-it dhe sistemimi i tyre në dosje fizike, elektronike dhe SIMBNJ.

- Pjesëmarrja në takimin e organizuar nga Agjencioni Kundër Korrupsionit, dorëzimi i listës me emrat e zyrtareve të larte publik të PZAP-it në AKK, dorëzimi i shkresës lidhur me mos pranimin e dhuratave për vitin 2016 nga PZAP-i, njoftimi i zyrtareve të lartë të PZAP-it për deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë.
- Asistimi në plotësimin e tabelës me të dhënat e nëpunësve civil për vitin 2016 (struktura e pozitive, kualifikuese arsimore, përkatësia etnike gjinore, vlerësimi i rezultateve, shpallja e konkurseve) dhe dorëzimi i tyre në MAP.
- Plotësimi i formularit me të dhënat e nëpunësve civil për pozita të larta drejtuese në bazë të kërkesës së MAP-it.
- Përgatitja e dokumenteve për çështjet e personelit, sipas kërkesës së auditorëve.
- Përgatitja dhe dorëzimi i kërkesës në Ministrin e Financave, për disponueshmërinë e mjeteve buxhetore për pozitën e drejtorit të zyrës ligjore.

Aktivitetet e prokurimit për nevoja të PZAP-it

- Përgatitja e Planifikimit Paraprak të Prokurimit Publik të PZAP-it për vitin 2017,
- Dorëzimi në mënyra fizike dhe elektronike i Planit Final të Prokurimit Publik për vitin 2017 Në Agjencinë Qendror të Prokurimit (AQP),
- Përgatitja e raportit për kontratat e nënshkruara të PZAP-it për vitin 2016 dhe dorëzimi në Komisionin Rregullativ të Prokurimit (KRPP),
- Përgatitja e një raporti me të dhënat e të gjitha kontratave valide që ka nënshkruar PZAP-i me operatorët ekonomik,
- Zhvillimin e aktivitetit të Prokurimit Publik dhe lidhjen e Kontratës për blerjen e fotokopjes.
- Si aktivitet tjetër me rëndësi në Prokurimin Publik të PZAP-it, ka qenë urdhër blerja për të gjitha kontratat që i kemi të lidhura me Operatoret Ekonomik .
- Menaxhimi i kontratës për Aktivitetin e prokurimit me titull “Shërbimet e Pastrimit dhe Mirëmbajtja e Hapësirave të PZAP-it”, Kohëzgjatja e kësaj kontrate është deri me 07.03.2018,
- Menaxhimi i kontratës me titull Furnizim me karburante për automjete të PZAP-it. Kohëzgjatja e kësaj kontrate është deri me 19.09.2017,
- Lidhja e kontratës për furnizim me pajisje të teknologjisë informative-llap top për anëtarët e PZAP-it,
- Lidhja e kontratës për furnizim me formularë në gjuhët zyrtare (shqip, serbisht dhe turqisht) për Zgjedhjet Lokale të 22 Tetorit 2017

- Lidhja e kontratës për furnizim me formularë në gjuhën Brail për persona me aftësi të kufizuara, për Zgjedhjet Lokale të 22 Tetorit 2017.
- Zhvillimi i procedurës së Prokurimit për furnizim me aparat për ngrohje të zyrave të institucionit të PZAP-it.

BASHKËPUNIMI I PZAP-IT ME AKTERET E ZGJEDHJEVE

Në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit të nënshkruar në vitin 2016, në mes të aktereve të zgjedhjeve, PZAP-it, KQZ-së, Prokurorit të Shtetit, Policisë së Kosovës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, PZAP ka implementuar të gjitha objektivat dhe aktivitetet e parapara në bazë të këtij Memorandumi. Niveli i bashkëpunimit me akteret e këtij memorandumi është ngritur gjatë Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më datë 11 Qershor 2017 si dhe Zgjedhjet Lokale të 22 tetorit 2017. Me qellim të koordinimit të aktiviteteve në mes të aktereve të zgjedhjeve nënshkrues të Memorandumit janë mbajtur takime të rregullta në të cilat takime zyrtaret përgjegjës të këtyre institucioneve kane ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për mbarëvajtjen e dy proceseve zgjedhore të mbajtura në vitin 2017.

Bashkëpunimi i PZAP-it me KQZ-në

Gjatë vitit 2017-të PZAP dhe KQZ kanë pasur një bashkëpunim të zakonshëm në mes tyre i cili komunikim dhe bashkëpunim është bazuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme – LZP dhe Rregullat Zgjedhore, Rregullat e brendshme të PZAP-it si dhe në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit të nënshkruar në vitin 2016. Bashkëpunimi ka qenë i vazhdueshëm dhe në veçanti niveli i bashkëpunimit është rritur gjatë zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvend të Kosovës të 11 Qershorit të vitit 2017 dhe Zgjedhjeve Lokale të 22 Tetorit 2017.

Kryesuesja e PZAP-it Znj. Gyltene Sylejmani dhe kryesuesi i Sekretariatit të PZAP-it Z. Mulë Desku kanë marrë pjesë në takimin e organizuar nga KQZ-ja me rastin e Ditës Botërore të Zgjedhjeve, në të cilën ngjarje pjesëmarrës ishin edhe përfaqësues të institucioneve të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, përfaqësues nga subjektet politike, shoqëria civile dhe organizatat ndërkombëtare si: OSBE, IFES etj..

- Shkëmbimin e informatave të nevojshme me Zyrën për Regjistrimin Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC), për sigurimin e adresave të përfaqësuesve të subjekteve politike, njoftimin

lidhur me gjobat e papaguara para certifikimit të subjekteve politike, kandidateve të subjekteve politike për deputet si dhe kandidateve të pavarur për zgjedhjet e 11 Qershorit 2017 dhe anëtarëve për kuvende komunale dhe kandidateve për kryetar të komunave për Zgjedhjet Lokale të 22 Tetorit 2017, njoftimin lidhur me personat të cilët në bazë të vendimeve të PZAP-it janë dënuar dhe iu është ndaluar pjesëmarrja e tyre në zgjedhje si kandidat apo si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor nën autoritetin e KQZ-së.

- Shkëmbimi i informatave me Zyrën Ligjore dhe Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve – QNR të KQZ-se, lidhur me sigurimin e materialeve zgjedhore për hetimin e rasteve në QNR.
- Shkëmbimi i informatave lidhur me ruajtjen e materialit zgjedhor në kutit e votimit për rastet me elemente të veprës penale.
- Njoftimi i KQZ-se nga PZAP-i për përfundimin e procesit ankimor dhe për vendosjen e të gjitha ankesave nga ana e PZAP-it për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe Zgjedhjet Lokale 2017, për të certifikuar rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve.

Bashkëpunimi i PZAP-it me Zyrën e Prokurorit të Shtetit

Shkëmbimin e informatave për rastet e ankesave me element të veprës penale për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe Zgjedhjet Lokale 2017. Gjatë Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të 11 Qershorit 2017 PZAP-i ka informuar Zyrën e Prokurorit të Shtetit me rastet e paraqitura në ankesat e tyre nga ankuesit lidhur me parregullsitë e zgjedhjeve siç ka qenë rasti i publikimit të spotit nga subjekti politik Lista Serbe kundër integritetit të Shtetit të Kosovës.

PZAP-i pas përfundimit të zgjedhjeve të 11 Qershorit 2017, e ka njoftuar Zyrën e Prokurorit të Shtetit me rastet e ndalimit të 14 kryesuesve të Vendvotimeve për shkak të moskryerjes së detyrave nga ana e tyre në përputhje me LZP dhe Rregullat zgjedhore si dhe ka dorëzuar një (1) rast për Zgjedhjet Lokale të 22 tetorit 2017 - Rasti i votimit me postë në Komunën e Istogut për Kryetar të Komunës në Raundin e Dytë i cili është mbajtur me 19.11.2017 .

Zyra e Prokurorit të Shtetit i është përgjigjur PZAP-it në njoftimin e tij me informatën kthyesë me të cilën ka informuar PZAP-in se, Prokurori i Shtetit i ka pranuar rastet dhe në bazë të kompetencës territoriale i ka deleguar rastet në kompetencën e Prokurorive Themelore - Kryeprokurorëve të prokurorive përkatëse me qëllim të shqyrtimit dhe verifikimit të ankesave dhe parashtresave si dhe të trajtimit të këtyre rasteve me prioritet dhe me urgjencë.

Bashkëpunimi i PZAP-it me Policinë e Kosovës

Bashkëpunimi në mes të PZAP-it dhe Policisë së Kosovës (PK) ka qenë i shkëlqyeshëm prej fillimit e deri në përfundimin e procesit zgjedhor për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të 11 Qershorit 2017 si dhe procesit zgjedhor për Zgjedhjet Lokale të 22 Tetorit 2017.

PZAP-i gjatë zgjedhjeve ka njoftuar Policinë e Kosovës dhe ka kërkuar informata nga ajo për rastet e ankesave me pretendimet se kanë pasur të bëjnë me element të veprës penale.

Policia e Kosovës, për të gjitha rastet dhe për hetimet e bëra lidhur me parregullsitë pretenduara në ankesat e ankuesve të paraqitura në PZAP, ka raportuar PZAP-in me kohë dhe i ka mundësuar PZAP-it që të vendos lidhur me ankesat brenda afatit ligjor.

Toger Bajram Shabani, Shefi i Sektorit për Planifikim Permanent të Departamentit të Operacioneve - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës në Prishtinë, në baza ditore e ka informuar PZAP-in për të gjitha tubimet dhe ngjarjet tjera të zhvilluara nga subjektet politike gjatë fushatës zgjedhore për dy proceset zgjedhore të vitit 2017.

Bashkëpunimi me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian – OSBE

Në vazhden e bashkëpunimit të vazhdueshëm në mes të PZAP-it dhe OSBE-së, kjo e fundit ka organizuar punëtoritë të përbashkëta me Trupat Menaxhues të Zgjedhjeve (TMZ) dhe me OJQ nëpër qendra të ndryshme të Kosovës me qëllim të përgatitjes së tyre për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të 11 Qershorit 2017 dhe Zgjedhjet Lokale të 22 Tetorit 2017.

Në muajin mars 2017 është organizuar punëtorja në komunën e Prizrenit, ku pjesëmarrës në këtë punëtori ishin përfaqësuesit e OSBE-së të sekretariatit të PZAP-it, të sekretariatit të KQZ-së, zyrtarët komunal zgjedhor-ZKZ të komunave të regjionit të Prizrenit si dhe përfaqësuesit e disa organizatave jo qeveritare të Kosovës. Në këtë punëtori u diskutuan, praktikat nga zgjedhjet e kaluara, pastaj përgatitjet lidhur me zgjedhjet lokale të vitit 2017 si dhe të drejtat dhe obligimet e aktereve gjatë këtyre zgjedhjeve.

Takimet e tilla në mes të OSBE-PZAP-KQZ- janë mbajtur edhe në këto komuna të Kosovës: Pejë, Gjiilan, Ferizaj, Prishtinë dhe Mitrovicë.

Bashkëpunim ka pasur edhe në fushën e shkëmbimit të informatave gjatë gjithë proceseve zgjedhjeve si të 11 Qershorit 2017 dhe të procesit zgjedhor të 22 Tetor 2017, lidhur me numrin e

ankesave që janë paraqitur në PZAP, natyrat e ankesave, shqyrtimi dhe vendosja e tyre nga Paneli, njoftimi i Misionit të OSBE-se me ankesat për raste të caktuara dhe me vendimet e marra nga PZAP-i si dhe njoftimi i këtij Misioni nga PZAP-i me të gjitha statistikatat e Procesit të Zgjedhjeve të 11 Qershorit 2017 dhe Procesit Zgjedhor të 22 Tetor 2017.

Me datën 7 Qershor 2017 Kryesuesja e PZAP-it znj. Gyltene Sylejmani me bashkëpunëtorët saj e ka pritur në takim zyrtar në PZAP, Ambasadorin e OSBE-se në Kosovë Z. Jan Brathu, bashkë me koordinatoren nacional të Zgjedhjeve pranë Misionit të OSBE-se në Kosovë z. Bujar Basha. në takim është biseduar për përgatitjet e PZAP-it për procesin e zgjedhjeve nacionale dhe me këtë rast Ambasadori i OSBE-se i ka dorëzuar kryesueses së PZAP-it 500 formularëve të ankesave në alfabetin brail për personat me aftësi të kufizuar në të tri gjuhët zyrtare në Kosovë.

Formularët e ankesave në alfabetin brail për personat me aftësi të kufizuar për herë të parë janë prodhuar në Kosovë dhe kësaj kategorie të personave për herë të parë ju është ofruar mundësia për tu informuar për të drejtat e tyre në zgjedhje dhe mbrojtjen e votës së tyre gjatë procesit zgjedhor.

Bashkëpunimi i PZAP-it me Fondacionin Ndërkombëtarë për Sisteme Zgjedhore - IFES

IFES-i gjatë vitit 2017 ka mbështetur PZAP-in në organizimin 12 trajnimeve në të cilat trajnime kane marre pjesë zyrtarët e Sekretariatit dhe anëtarët e PZAP-it.

IFES-it ka mbështetur dhe ndihmuar institucionin e PZAP-it edhe në fushën e informimit publik, respektivisht në përgatitjen e dy spoteve televizive me qëllim të vetëdijesimit të votuesve për zgjedhje, vetëdijesimin për të mbrojtur votën nga shkeljet apo parregullsitë gjatë proceseve zgjedhore, dhe mënyrën se si të paraqesin ankesat e tyre në PZAP. Spoti tjetër i përgatitur nga IFES-i ka qenë me karakter informues lidhur me krimin në zgjedhje dhe pasojat e tij.

Po ashtu shkëmbimi informatave gjatë gjithë procesit të zgjedhjeve të 11 Qershorit 2017 dhe procesit zgjedhor të 22 Tetor 2017, dhe mbikëqyrja e funksionimit të Sistemit Menaxhimit të Ankesave dhe Apeleve.

TRANSPARENCA - KOMUNIKIMI DHE INFORMIMI PUBLIK

Transparenca me Misionin e Bashkimit Evropian në Kosovë për Vëzhgimin e Zgjedhjeve - MBEVZ

PZAP-i ka qenë transparent dhe i ka ofruar qasje Misionit të Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve - MBEVZ në Kosovës në të gjitha informatat e kërkuara nga ky mision për numri i ankesave që janë paraqitur dhe vendosur nga PZAP gjatë dy proceseve të zgjedhjeve të vitit 2017, natyrën e ankesave, dhe informata tjera statistikore të këtyre zgjedhjeve.

PZAP-i me përfaqësuesin e MBEVZ në Kosovë i cili ka qenë i autorizuar për vëzhgimin e procesit ankimorë në PZAP kanë mbajtur takime sipas nevojës në të cilat takime janë shkëmbyer informata lidhur me ankesat dhe apelet e vendosura nga PZAP-i gjatë dy proceseve zgjedhore të vitit 2017.

Përfaqësuesi i këtij misioni është njoftuar nga PZAP-i dhe sipas mundësive të tij ai ka marrë pjesë në disa seanca dëgjimore të mbajtura nga Paneli i PZAP-i me rastin e shqyrtimit dhe vendosjes së ankesave dhe apeleve të paraqitura gjatë zgjedhjeve, etj..

Komunikimi me media dhe me publikun

Kryesuesi i Sekretariatit të PZAP-it Mulë Desku, është autorizuar nga PZAP-it për të komunikuar me mediat elektronike dhe të shkruara për ti njoftuar ato dhe përmes tyre opinionin publik me gjitha punët dhe aktivitetet e rëndësishme të PZAP-it gjatë procesit zgjedhor të 11 Qershorit 2017 dhe 22 Tetorit 2017 prej fillimit e deri në përfundimin e këtyre dy proceseve zgjedhore.

Në zbatim të autorizimeve të dhëna nga PZAP-i, kryesuesi i Sekretariatit të PZAP-it ka marrë pjesë në disa emisione televizive në Radio Televizionin e Kosovës - RTK, Koha Vizion – KTV dhe TV Tribuna. Përmes paraqitjeve në këto emisione kryesuesi i Sekretariatit ka njoftuar publikun me aktivitetet e planifikuara dhe të kryera nga PZAP-i për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura me 11 Qershor 2017 dhe për Zgjedhjet Lokale të 22 Tetorit 2017.

PZAP-i ka informuar publikun me të gjitha zhvillimet që kanë ndodhur në institucionin e PZAP-it gjatë dy proceseve zgjedhore të vitit 2017 dhe atë me numrin e ankesave të paraqitura, vendosjen e tyre, sanksionet dhe gjobat e shqiptuara ndaj subjekteve politike dhe ndalimi nga PZAP-i që ju është bërë Kryesuesve të vendotimeve për moskryerjen e detyrave të tyre në përputhje me Ligjin e Zgjedhjeve të Përgjithshme – LZP gjatë zgjedhjeve etj..

Te gjitha mediave të Kosovës, elektronike dhe të shkruara, iu është dhënë mundësia që të kenë qasje në të gjitha informatat e kërkuara për të gjitha aktivitetet e kryera nga PZAP-i për dy palë të zgjedhjeve të mbajtura në vitin 2017.

Konferencat publike me media për Zgjedhjet e 11 Qershorit 2017 :

1. Konferenca e parë është organizuar me datën 16.06.2017 në të cilën konference Adnan Konushevc, anëtari i PZAP-it dhe Mulë Desku, kryesues i Sekretariatit të PZAP-it, kanë informuar opinionin publik me numrin e ankesave të parashtruara nga subjektet politike, kandidatet për deputet në Kuvendin Republikës së Kosovës, qytetarët, anëtarët e Trupave Menaxhuese të Zgjedhjeve - TMZ, si dhe Organizatat Jo Qeveritare – OJQ. Gjithashtu në këtë konferencë opinionin publik është informuar me vendimmarrje në PZAP-it lidhur me ankesat dhe apelet e parashtruara për periudhat e para fushatës së zgjedhjeve, fushatës së zgjedhjeve, ditën e heshtjes së zgjedhjeve dhe ditën e votimit me 11 Qershor 2017, si dhe me sanksionet dhe gjobat e shqiptuara nga PZAP-i ndaj subjekteve politike.
2. Konferenca e dytë është organizuar me datën 03.07.2017. Edhe në këtë konferencë Adnan Konushevc, anëtari i PZAP-it dhe Mulë Desku, kryesues i Sekretariatit të PZAP-it, kanë informuar opinionin publik me numrin e ankesave të parashtruara nga kandidatet për deputet në Kuvendin Republikës së Kosovës dhe me vendimmarrjen e PZAP-it lidhur me ankesat e parashtruara pas shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve nga KQZ-ja me datën 29.06.2017, si dhe me sanksionet dhe gjobat e shqiptuara nga PZAP-i ndaj subjekteve politike për gjithë procesin zgjedhor.

PZAP-i për Zgjedhjet Lokale të 22 Tetor 2017 me qëllim të ngritjes së transparencës ka ndërmarr një sërë aktivitete, duke bërë publikimin e menjëhershëm të të gjitha informacioneve në ueb faqen e PZAP-it dhe ofrimin e qasjes në kohë për progresin e të gjitha rasteve nëpërmjet sistemit SMAA në të dy gjuhët zyrtare. Kështu që gjatë këtij procesi zgjedhor PZAP-i ka postuar në ueb faqen e tij një pyetësor me qëllim të pranimit të opinionëve të qytetarëve lidhur me procesin e ankimimit duke bërë përfshirjen e pyetjeve dhe përgjigjeve për qytetarët. Po ashtu PZAP-i përmes komunikimeve në rrjete sociale ka bërë këto komunikime me palët e interesit:

- në ueb faqe të PZAP-it janë publikuar 32 komunikata,
- në email adresë të PZAP-it janë bërë 130 komunikime,
- në faqen e facebook-ut të PZAP-it janë postuar 22 postime dhe 30 komunikime.

Mediave të shkruara dhe portaleve të ndryshme u janë dhënë rreth 30 informata të shkruara lidhur me numrin e ankesave, vendosjen e tyre gjatë proceseve zgjedhore për Zgjedhjet Lokale të 22

Tetorit 2017 si për raundin I-rë, raundin e II-të si dhe për Rivotim në Komunën e Parteshit dhe në Komunën e Istogut për kryetar të këtyre komunave.

Mediave të shkruara dhe elektronike u janë dhënë dhjetëra deklaratë dhe intervista, me të cilat opinioni publik është informuar me numrin e ankesave dhe vendosjen tyre gjatë proceseve zgjedhore për Zgjedhjet Lokale të 22 Tetorit 2017 si për raundin I-rë, raundin e II-të si dhe për Rivotim në Komunën e Parteshit dhe në Komunën e Istogut për kryetar të këtyre komunave.

Mediat në mënyrë profesionale kanë informuar opinionin publik për punën e PZAP-it gjatë dy proceseve zgjedhore të vitit 2017. Transparenca e PZAP-i me publikun për punën e kryer në shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave dhe apeleve në përputhje me ligj dhe brenda afateve kohore të përcaktuara me LZP ka rritur besimin tek publiku.

Publikimi në Radio Televizionin Publik të Kosovës - RTK i dy spoteve me titull “Si të dorëzohen ankesat në zgjedhje”, dhe “Krimi në Zgjedhje” ka ndikuar në vetëdijesimin e të gjithë pjesëmarrësve të procesit të zgjedhjeve për të shfrytëzuar të drejtën e tyre për tu ankuar në PZAP dhe për të marrë përgjigje lidhur me parregullsitë që kanë ndodhur gjatë zgjedhjeve dhe në përmirësimin e këtyre parregullsive, si dhe në parandalimin e pjesëmarrësve në kryerjen veprave penale në zgjedhje. Prodhimin e këtyre dy spoteve e ka financuar IFES-i.

Tryezat e organizuara nga Instituti Demokracia për Zhvillim (D4D)

Instituti Demokracia për Zhvillim (D4D) në partneritet me Demokracia në Veprim (DNV) ka organizuar shtatë (7) tryeza për “Drejtësi zgjedhore në zgjedhjet e 11 Qershorit”, në Gjakovë dhe Pejë, me 5 Qershor 2017, në Mitrovicë me 6 Qershor 2017, në Prizren me 7 Qershor 2017, në Gjiilan me 08 Qershor 2017, në Prishtinë me 09 Qershor 2017, në këtë tryezë pjesëmarrësve ju është adresuar edhe Ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë z. Greg Delawie, në Graçanicë me 09 Qershor 2017. Tryezat janë organizuar gjatë fushatës zgjedhore. Në këto tryeza kemi qenë të ftuar si panelist dhe kemi informuar pjesëmarrësit dhe opinionin publik lidhur me mandatin e PZAP-it, përbërjen e PZAP-it dhe sekretariatit, si të parashtrohen ankesat në PZAP dhe informata tjera me qëllim të parandalimit dhe luftimit të parregullsive të zgjedhjeve duke paraqitur këto parregullsi përmes ankesës dhe dorëzimin e saj në PZAP. Në Tryezën organizuar në Gjiilan ka marrë pjesë anëtar i PZAP-i Zyhdi Haziri, ndërsa në tryezat tjera ka marrë pjesë Mulë Desku, kryesues i Sekretariatit të PZAP-it. Në tryezën e mbajtur në Prizren për shkak të angazhimeve të anëtarëve dhe stafit të Sekretariatit nga PZAP-i nuk ka marrë pjesë askush.

Në këto tryeza përveç përfaqësuesit të PZAP-it kanë marrë pjesë dhe përfaqësuesit e Prokurorisë së Shtetit, Përfaqësuesit e Policisë së Kosovës, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Këshillit Gjyqësor i Kosovës ka qenë i ftuar dhe i obliguar për të marrë pjesë në këto tryeza, por nuk ka dërguar asnjë herë përfaqësuesin e saj në këto tryeza.

Tryeza e Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD)

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) me përkrahje të Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ka ftuar Kryetaren e PZAP-it znj. Gyltene Sylejmani për të marrë pjesë në cilësinë e panelistës, në tryezën e organizuar për të diskutuar për drejtësinë në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikë së Kosovës 2017. Tryeza është mbajtur me 7 Qershor 2017 në Prishtinë.

Kryesuesja e PZAP-it për shkak të angazhimeve nuk ka pasur mundësi të përfaqësoj PZAP-in në këtë konferencë dhe në vend të saj PZAP-in e ka përfaqësuar kryesuesi i Sekretariatit të PZAP-it. Tryeza është titulluar “Drejtësia në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikë së Kosovës 2017”, në të cilën është diskutuar për përgatitjen dhe gatishmërinë e institucioneve të drejtësisë dhe sigurisë në sigurimin e mbarëvajtjes së procesit të zgjedhjeve.

Takimi me subjekte politike

PZAP-i para fillimit të fushatës së zgjedhjeve ka organizuar takim me përfaqësuesit e subjekteve politike me qëllim të caktimit të personave kontaktues dhe rritjes së bashkëpunimit gjatë proceseve të zgjedhjeve: për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të 11 Qershorit 2017 dhe Zgjedhjeve Lokale të 22 Tetorit 2017, në mes të PZAP-it dhe subjekteve politike. Gjithashtu përfaqësuesve të subjekteve politike të cilët ishin pjesëmarrës në këtë takim, PZAP-i në takim përfaqësuesve të subjekteve politike iu ka shpërndarë nga një udhëzues për ankesa dhe apele për zgjedhje me qëllim të informimit të tyre për paraqitjen e ankesave në PZAP.

Takimi me përfaqësuesit e OJQ-ve

PZAP-i me qëllim të rritjes së bashkëpunimit me Organizatat e Shoqërisë Civile – OJQ-ve, gjatë procesit të zgjedhjeve të 11 Qershorit 2017, para fillimit të fushatës së zgjedhjeve ka organizuar takim me përfaqësuesit e OJQ-ve si: Demokracia plus, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), Demokracia në Veprim etj. Përfaqësuesve të OJQ-ve, pjesëmarrës në këtë takim, PZAP-i ju ka

shpërndarë nga një udhëzues për ankesa dhe apele për zgjedhje me qëllim të informimit të tyre për paraqitjen e ankesave në PZAP, si dhe janë shkëmbyer informata të rëndësishme lidhur me procesin e zgjedhjeve. OJQ-të gjatë zgjedhjeve të 11 Qershorit 2017, kanë paraqitur në PZAP rreth 150 ankesa me çka kanë ndikuar në mbrojtjen e ligjit për mes ankesave të parashtruara dhe në sanksionimin e subjekteve politike për shkak të shkeljes së rregullave të LZP-se, ndërsa për procesin zgjedhor të 22 Tetorit 2017 kanë parashtruar 154 ankesa.

SHPERNDARJA E FORMULAREVE TË ANKESAVE:

PZAP-i për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të 11 Qershorit 2017 dhe Zgjedhjeve Lokale të 22 Tetorit 2017, në të gjitha Komisionet Komunale të Zgjedhjeve në 38 Komuna të Kosovës, ka bërë shpërndarjen e Formularëve të ankesave në të tri gjuhët: shqip, serbisht dhe turqisht. Formularët janë dorëzuar në Zyrat Komunale të Zgjedhjeve, ku Zyrtarët e Lartë të Komisioneve Komunale Zgjedhore i kanë shpërndarë në Qendrat e Votimit në ditën e zgjedhjeve.

Ne Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës janë shpërndarë 70,000 formularë të ankesave: 50,000 në gjuhën shqipe, 15,000 në gjuhën serbe dhe 5,000 në gjuhën turke.

Ne Zgjedhjet Lokale të 22 Tetorit 2017, për të dy raundet janë shpërndarë 80,000 formularë: 55,000 në gjuhën shqipe, 20,000 në gjuhën serbe dhe 5,000 në gjuhën turke.

Me qëllim të krijimit të kushteve të barabarte për të gjithë qytetarët e Kosovës në paraqitjen e parregullsive eventuale dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre gjatë zgjedhjeve, PZAP-i, në bashkëpunim me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian – OSBE, kanë arritur që për herë të parë në Kosovë në një proces zgjedhor të përgatisin të prodhojnë Formularë të ankesave në alfabetin Brail për personat e verbër.

Prodhimi i formularëve në alfabetin Brail është mundësuar me mjete financiare të fondit të ndarë nga OSBE-ja, respektivisht OSBE-ja ka kryer procedurat e prokurimit dhe ekzekutimin e pagesës për furnizimin me formular në alfabetin brail.

Dorëzimi i Formularëve të ankesave në alfabetin brail është bërë në një takim të mbajtur me datën 7 Qershor 2017 në selinë e PZAP-i, të cilin takim e ka organizuar Kryesuesja e PZAP-it znj. Gyltene Sylejmani, me stafin përcjellës të Sekretariatit të PZAP-it.

ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PËR KUVEND TË KOSOVËS TË MBAJTURA ME 11 QERSHOR 2017

REGJISTRIMI – VENDOSJA DHE ARKIVIMI I ANKESAVE/APELEVE PËR PROCESIN E ZGJEDHJEVE të 11 QERSHORIT 2017

Prej shpalljes së zgjedhjeve me datën 11 Maj 2017 deri me datën 30 Qershor 2017, respektivisht deri me përfundimin e afatit për paraqitjen ankesave nga kandidatët për deputet ndaj vendimit të KQZ-se për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura me 11 Qershor 2017, në PZAP janë parashtruar - gjithsejtë: 421 ankesa dhe apele dhe të cilat janë vendosur nga PZAP-i brenda afatit ligjor. PZAP-i të gjitha palëve ju ka dorëzuar vendimet lidhur me ankesat dhe apelet e parashtruara në mënyrë fizike brenda afatit ligjor si dhe të gjitha ankesa dhe apelet bashke me shkresat e lëndës i ka arkivuar në mënyrë fizike dhe elektronike.


Këto ankesa dhe apele i takojnë periudhës së zgjedhjeve të para fushatës, fushatës zgjedhore, ditës së heshtjes zgjedhore, ditës së zgjedhjeve, ankesa lidhur me shpalljen e rezultateve preliminare dhe ankesa lidhur me shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve nga KQZ-ja.

Gjatë zgjedhjeve të 11 Qershorit PZAP-i ka mbajtur 4 (katër) seancave dëgjimore.

Ne tabelën e mëposhtë është paraqitur numri i ankesave dhe apeleve të parashtruara në PZAP sipas fazave Procesit Zgjedhor:


Nr.	Fazat e procesit zgjedhor	Numri i ankesave	Numri i apeleve
1	Para fushatës zgjedhore	0	21
2	Gjatë fushatës zgjedhore	177	0
3	Thyerjen e heshtjes zgjedhore	88	0
4	Ditën e votimit	67	0
5	Rezultatet preliminare	2	0
6	Ankesat lidhur me administrimin në Qendrën e Numërimit të Rezultateve (QNR)	0	0
7	Ankesat lidhur me Rezultatet Përfundimtare	66	0
Totali		400	21

Numri i ankesave sipas fazave gjatë Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës



Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat të cilat pasqyrojnë meritat e marrjes së vendimeve nga PZAP-i lidhur me ankesat dhe apelet të parashtuara

Nr	Mënyra e marrjes së vendimeve:	Ankesa
1	Të miratuara si të bazuara	179
2	Të refuzuar si të pabazuara	150
3	Të hedhur si të palejuara	33
4	Të hedhur si të pasafatshme	37
5	Të hedhur si të parregullta	4
6	Të tërhequra	16
7	Çështje e gjykuar	1
8	Dërguar në KPMK	1
Totali:		421



Ankesat e paraqitura dhe të vendosura nga PZAP-i pas publikimit të Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve nga KQZ-ja me datën 29.06.2017.

PZAP-i ka shqyrtuar dhe vendosur lidhur me ankesat e parashtruara nga kandidatet për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës brenda afatit ligjor prej 72 orëve prej momentit të shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në ora 14:20 të datës 30.06.2017 deri në ora 14:20 e datës 03.07.2017.

Gjithsejte janë paraqitur dhe PZAP-i ka vendosur për 66 ankesa.

Subjekti Politik	Nr. i ankesave	Të miratuara	Të refuzuara
Koalicioni PDK-AAK-Nisma...	23	20	3
Koalicioni LDK-AKR-ALT	19	9	10
Lista Srpska	11	9	2
Partija Kosovskih Srba	3	3	0
Partia Liberale Egjiptiane	3	3	0
Kosovo Demokratik Turk Partisi – DTP	3	1	2
Levizja Vetëvendosje – LVV	2	1	1
Kosovaki Nevi Romani Partia – KNRP	2	2	0
Gjithsejte	66	40	26

Ankesat e hetuara në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve - QNR – KQZ

Nga tri ekiye hetuesish të kryesuara nga tre anëtarë të PZAP-it dhe zyrtarë të administratës së Sekretariatit kanë bërë hetim në QNR me pretendimet ankimore të ankuesve për mospërputhje të rezultateve në Formularët e Përputhjes së Rezultateve – FPR dhe Formularët e Rezultateve të Kandidateve – FRK, lidhur me 24 ankesa për 30 kuti të votimit.

Nga hetimi ka rezultuar se 22 ankesa kanë qenë të bazuara dhe janë miratuar nga paneli, ndërsa 2 ankesa janë refuzuar si të pabazuara.

PZAP-i ka marrë vendim për miratimin e 18 ankesave si të bazuara pa hetim pasi që kanë poseduar dëshmi të mjaftueshme.

Për këto 18 ankesa, PZAP-i ka marrë Vendim dhe ka urdhëruar KQZ-n që të bëjë rinumërimin e 117 Kutive të Votimit, ndërsa 26 ankesat tjerat janë refuzuar si të pabazuara dhe hedhur poshtë si të pasafatshme.

PZAP-i ka marrë vendim që 14 Kryesuesve të Vendvotimeve të ju ndaloj të drejtën për 5 vite që të jenë pjesë administrative e zgjedhjeve të organizuara nga KQZ-ja, në zgjedhjet e ardhshme Lokale apo Parlamentare.

Këto 14 raste janë dorëzuar në Prokurorinë e Shtetit për kompetence të mëtejme.

Ankesat/Apelet e paraqitura ndaj vendimeve të PZAP-it në Gjykatën Supreme të Kosovës:

Gjatë Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura me 11 Qershor 2017, palët e pa kënaqura me vendimet e PZAP-it, kanë ushtruar të drejtën e tyre ligjore dhe i kanë apeluar vendimet e PZAP-it në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës.

Në Gjykatën Supreme të Kosovës janë paraqitur 11 ankesa kundër vendimeve të PZAP-it, prej të cilave 8 ankesa janë refuzuar ndërsa 3 ankesa janë miratuar.

Natyrat e vendimeve të PZAP-it, të cilat janë ankimuar në Gjykatën Supreme, janë si në vijim:

- Largimi i kandidateve për deputet nga Lista e Kandidatëve dy raste;
- Shfaqja e spoteve dhe përdorimi i gjuhës që nxitë urrejtje;
- Thyerje e heshtjes zgjedhore përmes rrjeteve sociale Facebook;
- Thyerje e heshtjes zgjedhore;
- Vendosja e posterave afër qendrës së votimit;
- Vota të regjistruara gabimisht në FPR dy raste
- Mungesa e votave;

- Keqpërdorim i votave;
- Administrim në QNR.

Me poshtë gjeni listën me Rastet e Apeluara në Gjykatën Supreme:


- AA.nr/2.2017 - Anr.04/2017 - Ndryshim i Vendimit të PZAP-it:
- AA.nr/3.2017 - Anr.21/2017 - Vërtetim i Vendimit të PZAP-it:
- AA.nr/4.2017 - Anr.120/2017 - Vërtetim i Vendimit të PZAP-it:
- AA.nr/5.2017 - Anr.209/2017 - Vërtetim i Vendimit të PZAP-it:
- AA.nr/6.2017 - Anr.290/2017 - Vërtetim i Vendimit të PZAP-it:
- AA.nr/7.2017 - Anr.299/2017 – Vërtetim i Vendimit të PZAP-it:
- AA.nr/10.2017- Anr.362/2017 – Vërtetim i Vendimit të PZAP-it:
- AA.nr/11.2017- Anr.372/2017 – Ndryshim i Vendimit të PZAP-it:
- AA.nr/9.2017 - Anr.373/2017 – Vërtetim i Vendimit të PZAP-it:
- AA.nr/8.2017 - Anr.390/2017 – Vërtetim i Vendimit të PZAP-it:
- AA.nr/12.2017- Anr.410/2017 – Ndryshim i Vendimit të PZAP-it:

Vendime të PZAP-it të apeluara në Gjykatën Supreme, Gjithsejte: 11 vendime
 Vendime të PZAP-it të vërtetuara nga Gjykata Supreme, Gjithsejte: 8 vendime
 Vendime të PZAP-it të ndryshuara nga Gjykata Supreme, Gjithsejte 3 vendime.

Natyra e ankesave dhe apeleve të zgjedhjeve të 11 Qershorit 2017


Nr	Natyra e ankesave	Nr. i ankesave
1	Blerje e votës	1
2	Cenimi i përcaktimit të lirë të votuesve	1
3	Administrimi në QNR	4
4	Bërja e fushatës më afër se 100 m nga QV-ja	5
5	Çrregullim i tubimeve të subjekteve të tjera	1
6	Dëmtim i Posterëve	2
7	Dhunë, kërcënim, shantazh	4
8	Fotografim i votës	4
9	Incident në fushat zgjedhore	1
10	Keqperdorim i votave	2
11	Keqpërdorimi i pasurisë publike dhe detyrës zyrtare	2
12	Kundërshtim për regjistrimin e subjektit politik	1

13	Largim nga lista e kandidatëve për deputet	5
14	Materiale propaganduese në vendvotim	1
15	Mbulim i Posterave	4
16	Mos emërimi i anëtarëve në KKZ	4
17	Parregullsi gjatë nominimit dhe emërimit të komisionerëve të KVV-ve	7
18	Mos certifikim i kandidatit në listën e kandidatëve të SP	1
19	Mos përfshirje në listën e votuesve, për votim jashtë vendit	4
20	Mospërputhje e votave	28
21	Mungesë e votave	14
22	Parregullsi gjatë ditës së votimit	7
23	Përdorimi i gjuhës që nxitë urrejtje	2
24	Presion të votuesit	7
25	Votim i dyfishtë	1
26	Votim i dyshimt	1
27	Votim pa dokumente valide	1
28	Votimi në emër të personit të vdekur	1
29	Vendosja e posterëve afër qendrës së votimit	18
30	Vendosja e posterëve në hapësira private	1
31	Vendosja e posterëve në hapësirë publike	155
32	Thyerje e heshtjes zgjedhore	6
33	Tërheqje nga lista e kandidatëve për deputet	4
34	Reklamim në Facebook – Thyerje e heshtjes zgjedhore	61
35	Qëndrimi i kandidatit për deputet në qendrën e votimit	1
36	Publikimi i videove pa autorizim	1
37	Shkelja e ligjit për kompleksin Adem Jashari	1
38	Vota të regjistruara gabim në FRK	31
39	Vota të regjistruara gabim në FPR	26
Total		421




Parashtruesit e ankesave/apelve në zgjedhjet e 11 Qershorit 2017

Nr.	Ankuesi	Nr. i ankesave
1	Instituti Demokratik Kosovës –IDK (KDI)	71
2	LVV	71
3	Demokracia Plus	46
4	LDK-AKR-Alternativa	59
5	BIRN DHE IKS	37
6	PDK-AAK-NISMA	60
7	Partia Kosovskih Serba - Gradjanska Iniciativa - PKS	21
8	Progresivna Demokratska Stranka - PDS	3
9	KKZ	3
10	Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës - PDAK	4
11	Partia Fjala	2
12	Kosovo Turk Adalet Partisi - KTAP	2
13	SDA-BSDK	2
14	Partia e Ashkanlive për Integrim - PAI	1
15	KVV	2
16	G.I Srpska Lista	13
17	Kosovo Demokratik Turk Partisi- KDTP	5
18	Partia Rome e Bashkuar të Kosovës - PREBK	1
19	SamostalnaLiberalnaStranka - SLS	1
20	VAKAT	1
21	AGI	1
22	Kosovaki Nevi Romani Partia - KNRP	2
23	Partia Liberale Egjiptiane - PLE	3
24	Edison Jakurti	1
25	Blerta Grajqevci	1
26	Novica Markovic	1
27	Berat Maqastena	1
28	Drita Kabashi	1
29	Agron Istrefi	1
30	Zejnepe Kamberi	1
31	Venera Kabashi	1
32	Vjosa Metaj	1
33	Besmir Berisha	1
Total		421




Kryerësit e supozuar në Zgjedhjet e 11 Qershorit 2017

Nr.	Kryerësi i supozuar	Nr. Ankesave
1	PDK-AAK-NISMA	113
2	LDK-AKR-Alternativa	76
3	LVV	52
4	KQZ, KKZ, KVV	125
5	G.I Srpska Lista	11
6	Partia Demokratike Turke e Kosovës - KDTP	6
7	OSBE	13
8	Partia Fjala	3
9	Progresivna Demokratska Stranka - PDS	3
10	Samostalna Liberalna Stranka - SLS	4
11	Partia e Askanlive për Integrim - PAI	2
12	IRDDNISP	1
13	Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës - PDAK	1
14	NaprednaSnaga Kosova - NDS	1
15	Partia Demokratike e Unitetit - PDU	1
16	Kosovski Nevi Romani Partia - KNRP	1
17	VAKAT	1
18	Kryersi i pa identifikuar	1
19	Klan Kosova	1
20	Gradjanska Inicijativa Gore - GIG	1
21	Partia Kosovskih Srba - PKS	1
22	Metush Sinani	1
23	Herolind Sejda	1
24	Haxhi Bejta	1
25	Vllaznim Pergjegjaj	1
26	Enver Demiri	1
27	Vesel Veseli	1
28	Elbasan Morina	1
29	Naser Canolli	1
30	Avni Ibrahim	1
31	Isen Çerkezi	1
Total		428



Ankesat e parashtruara sipas komunave ku kanë ndodhur shkeljet gjatë Zgjedhjeve të 11 Qershorit 2017

Nr.	Komuna	Nr. i ankesave
1	Deçan	8
2	Drenas	3
3	Ferizaj	21
4	Fushë Kosovë	4
5	Gjakovë	13
6	Gjilan	35
7	Graçanicë	13
8	Istog	4
9	Jashtë Kosovës	4
10	Junik	2
11	Kamenicë	19
12	Klinë	4
13	Leposaviq	19
14	Lipjan	12
15	Malishevë	12
16	Mamushë	2
17	Mitrovicë	16
18	Novobërd	3
19	Obiliq	7
20	Pejë	20
21	Podujevë	11
22	Prishtinë	134
23	Prizren	22
24	Rahovec	1
25	Shtërpçë	3
26	Shtime	5
27	Skenderaj	6
28	Suharekë	8
29	Viti	5
30	Zubin Potok	2
31	Zveçan	2
32	Vushtrri	1
Total		421



PZAP-i ka shqipëruar gjoba ndaj subjekteve politike për shkak se kanë thyer kodin e mirësjelljes se LZP gjatë fushatës zgjedhore në shumë prej, Gjithsejtë: **348,900.00 euro**

Koalicioni - PDK,AAK,NISMA etj.	158,000.00 euro
Koalicioni LDK-AKR-ALTERNATIVA etj.	71,700.00 euro
LVV	62,600.00 euro
G.I.SRPSKA LIST	35,600.00 euro
Kosovo Demokratik Turk Partisi - KDTP	8,400.00 euro
Samostalna Liberanlna Stranka - SLS	3,800.00 euro
Progresivna Demokratska Stranka - PDS	2,600.00 euro
Partia FJALA	2,600.00 euro
Partia e Ashkalive për Integrim - PAI	1,200.00 euro
Partia Demokratike e Unitetit – PDU	1,200.00 euro
Koalicioni – VAKAT	1,200.00 euro
Gjithsejtë:	348,900.00 euro

Rastet e dorëzuara në Zyrën e Prokurorit të Shtetit

1. Rasti Anr. 359/2017, paraqitur nga kandidati për deputet i Koalicionit PDK-AAK-NISMA etj., Vendvotimi 0103C/03R Shkolla Fillore "Drita", fshati Gramaçel, Komuna e Deçanit, Parregullsi gjatë numërimit të votave dhe mos regjistrimi në FPR ose FRK.
2. Rasti Anr. 360/2017, paraqitur nga kandidatja për deputete e Koalicionit PDK-AAK-NISMA etj. Vendvotimi 1307e/05R Shkolla Fillore "Zenel Hajdini", fshati Gadime e Ulët, Komuna e Lipjanit. Parregullsi gjatë numërimit të votave dhe mos regjistrimi në FPR ose FRK.
3. Rasti Anr. 361/2017, paraqitur nga kandidati për deputet i Koalicionit PDK-AAK-NISMA etj. Vendvotimi 2201e/02R Shkolla e Mesme "Naim Frashëri", Komuna e Shtimes. Parregullsi gjatë numërimit të votave dhe mos regjistrimi në FPR ose FRK.
4. Rastet Anr.363/2017 dhe Anr. 371/2017. paraqitur nga kandidatet për deputet të Koalicionit PDK-AAK-NISMA etj., Vendvotimi 2516D/01R Shkolla Fillore "Ali Hadri", fshati Mirash Komuna e Ferizajt. Parregullsi gjatë numërimit të votave dhe mos regjistrimi në FPR ose FRK.
5. Rastet Anr.364/2017, Anr. 370/2017 dhe Anr.389/2017. paraqitur nga kandidatet për deputet të Koalicionit PDK-AAK-NISMA etj., Vendvotimi 2521D/01D Shkolla Fillore e Mesme e

Ulet "Ganimete Tërbeshi, fshati Talinoc I Jerlive Komuna e Ferizajt. Parregullsi gjatë numërimit të votave dhe mos regjistrimi në FPR ose FRK

6. Rasti Anr. 365/2017, paraqitur nga kandidati për deputet i Koalicionit PDK-AAK-NISMA etj., Vendvotimi 2121b/01R Shkolla Fillore "Kuvendi I Drenicës", fshati Abri e Poshtme Komuna e Skenderajt. Parregullsi gjatë numërimit të votave dhe mos regjistrimi në FPR ose FRK.
7. Rasti Anr.368/2017. Paraqitur nga një votues. Vendvotimi 0108c/01R Shkolla Fillore "Isa Boletini", fshati Isniq Komuna e Deçanit. Parregullsi gjatë numërimit të votave dhe mos regjistrimi në FPR ose FRK.
8. Rasti Anr.377/2017, paraqitur nga kandidati për deputet i subjektit politik KDTP. Vendvotimi 2004a/07R Shkolla Fillore "Motrat Qiriazhi", Komuna e Prizrenit. Parregullsi gjatë numërimit të votave dhe mos regjistrimi në FPR ose FRK.
9. Rasti Anr. 383/2017. Paraqitur nga kandidati për deputet i Koalicionit LDK-AKR-etj., Vendvotimi 2510d/04R Shkolla Fillore "Besim Rexhepi", fshati Komogllav, Komuna e Ferizajt. Parregullsi gjatë numërimit të votave dhe mos regjistrimi në FPR ose FRK.
10. Rasti Anr. 385/2017. Paraqitur nga kandidati për deputet i Koalicionit LDK-AKR-etj., Vendvotimi 2532d/01R , fshati Ternë Komuna e Ferizajt. Parregullsi gjatë numërimit të votave dhe mos regjistrimi në FPR ose FRK.
11. Rasti Anr. 386/2017, paraqitur nga kandidati për deputet i Koalicionit PDK-AAK-NISMA etj., Vendvotimi 2512d/02D Shkolla Fillore "Dituria", fshati Tankosiq Komuna e Ferizajt. Parregullsi gjatë numërimit të votave dhe mos regjistrimi në FPR ose FRK.
12. Rasti Anr. 388/2017, paraqitur nga kandidati për deputet i Koalicionit PDK-AAK-NISMA etj., Vendvotimi 2502x/07D Shkolla "Gjon Sereqi", Komuna e Ferizajt. Parregullsi gjatë numërimit të votave dhe mos regjistrimi në FPR ose FRK.
13. Rasti Anr. 400/2017. Paraqitur nga kandidati për deputet i Koalicionit LDK-AKR-etj., Vendvotimi 1922e/01R Shkolla Fillore "EminDuraku", Komuna e Prishtinës. Parregullsi gjatë numërimit të votave dhe mos regjistrimi në FPR ose FRK.
14. Rasti Anr. 417/2017. Paraqitur nga kandidatja për deputete e Koalicionit LDK-AKR-etj., Vendvotimi 3042a/02D Shkolla Fillore "Dëshmorët e fshatit", fshati Bubavec, Komuna e Malishevës. Parregullsi gjatë numërimit të votave dhe mos regjistrimi në FPR ose FRK.

ZGJEDHJET LOKALE TË MBAJTURA ME 22 TETOR 2017

REGJISTRIMI – VENDOSJA DHE ARKIVIMI I ANKESAVE/APELEVE PËR PROCESIN E ZGJEDHJEVE TË 22 TETORIT 2017


Që nga fillimi i procesit zgjedhor për Zgjedhjet Lokale të 22 tetorit 2017 deri me certifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve nga KQZ-ja në PZAP janë parashtruar - gjithsejtë: 1142 ankesa dhe apele dhe të cilat janë vendosur nga PZAP-i brenda afatit ligjor. PZAP-i të gjitha palëve iu ka dorëzuar vendimet lidhur me ankesat dhe apelet e parashtruara në mënyrë fizike brenda afatit ligjor si dhe të gjitha ankesa dhe apelet bashke me shkresat e lëndës i ka arkivuar në mënyrë fizike dhe elektronike.

Këto ankesa dhe apele i takojnë periudhës së zgjedhjeve të para fushatës, fushatës zgjedhore, ditës së heshtjes zgjedhore, ditës së zgjedhjeve, ankesa lidhur me shpalljen e rezultateve preliminare, ankesa lidhur me shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve nga KQZ-ja, ankesat e parashtruara për raundin e II-të të zgjedhjeve si dhe ankesat e paraqitura për përsëritjen e votimit për kryetar të Komunës së Parteshit dhe për përsëritjen e votimit të raundit të dytë të Zgjedhjeve për Kryetarë në Komunën e Istogut.

Gjatë zgjedhjeve të 22 tetorit 2017 PZAP-i ka mbajtur 5 seanca dëgjimore.


Ankesat e parashtruara sipas fazave të procesit zgjedhor për raundin e I për vitin 2017

Nr.	Fazat e procesit zgjedhor	2017
1	Para fushatës zgjedhore	35
2	Gjatë fushatës zgjedhore	223
3	Thyerjen e heshtjes zgjedhore	39
4	Ditën e votimit	187
5	Ankesat lidhur me rezultatet preliminare “K-Vote” të Kandidatëve për Anëtarë të Kuvendeve Komunale	78
6	Ankesat lidhur me rezultatet përfundimtare të shpallura nga KQZ-ja të Kandidatëve për Anëtarë të Kuvendeve Komunale	511
7	Ankesat lidhur me shpalljen e rezultateve përfundimtarë nga KQZ-ja të Kandidatet për Kryetar të Komunave	5
Totali		1078



Ankesat e parashtruara sipas fazave të procesit zgjedhor për raundin e II- për vitin 2017

Nr.	Fazat e procesit zgjedhor	2017
1	Para fushatës zgjedhore	0
2	Gjatë fushatës zgjedhore	3
3	Thyerjen e heshtjes zgjedhore	18
4	Ditën e votimit	8
5	Ankesat lidhur me rezultatet preliminare “K-Vote” të Kandidatëve për Kryetar të Komunave	11
6	Ankesat lidhur me shpalljen e rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja të Kandidatëve për Kryetar të Komunave	9
Totali		49




Ankesat e pranuar gjatë procesit zgjedhor të rivotimit për kryetar të Komunës së Istogut

Nr	Mënyra e vendosjes	Nr. i ankesave
1	Hudhet si e palejuar	1
2	Refuzohen	14
	Totali:	15

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat të cilat pasqyrojnë meritat e marrjes së vendimeve nga PZAP-i lidhur me ankesat dhe apelet të parashtruara për Zgjedhjet Lokale 2017

Nr.	Mënyra e marrjes së vendimeve:	2017
1	Të aprovuara si të bazuara	190
2	Të refuzuar si të pabazuara	462
3	Të hedhur si të palejuara	182

4	Të hedhur si të pasafatshme	68
5	Të hedhur si të parregullta	83
6	Të tërhequra	22
7	Çështje e gjykuar	3
8	Dërguar në KPM	0
9	Shpallur inkmpetent	0
10	Miratohe për rinumërim	131
11	Miratohe për rivotim	2
12	Rishikohet vendimi i PZAP-it	3
Totali:		1142



Ankesat e hetuara në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve - QNR – KQZ, për raundin e I-rë të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura më 22 tetor 2017

Në QNR nga 5 (pesë) ekupe hetuesish të kryesuar nga 5 (pesë) anëtarë të PZAP-it dhe zyrtarë të administratës së sekretariatit kanë bërë hetim me pretendimet ankimore të ankuesve për mospërputhje të rezultateve në Formularët e Përputhjes së Rezultateve – FPR dhe Formularët e Rezultateve të Kandidateve – FRK, lidhur me 24 ankesa për 38 kuti të votimit,

Nga hetimi ka rezultuar se 9 ankesa kanë qenë të bazuara dhe janë miratuar nga paneli. Ndërsa 15 ankesa janë refuzuar si të pabazuara.

Për këto 131 ankesa, PZAP-i ka marrë Vendim dhe ka urdhëruar KQZ-n që të bëjë rinumërimin e 440 Kutive të Votimit.

Ankesat e hetuara në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve - QNR – KQZ, për raundin e II-të të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura më 19 Nëntor 2017

Në QNR janë zhvilluar hetime nga 5 (pesë) ekipe hetuesish të kryesuar nga 5 (pesë) anëtarë të PZAP-it dhe zyrtarë të administratës së sekretariatit, si rezultat i pretendimeve ankimore me të ankuesve për mospërputhje të rezultateve në Formularët e Përputhjes së Rezultateve – FPR si dhe lidhur me pretendimet ankimore për votuesit jashtë Kosovës,

Hetimet janë kryer për 3 ankesa, gjithsej 38 kuti të votimit,

Nga hetimi ka rezultuar se 1 ankesë e pranuar nga ana e subjektit politik LDK ka qenë e bazuar dhe është miratuar nga paneli. Ndërsa 2 ankesa të pranuara nga subjektet politike LDK dhe Lista Serbe janë refuzuar si të pabazuara.

Për këto 2 ankesa, PZAP-i ka marrë Vendim dhe ka urdhëruar KQZ-n që të bëjë rinumërimin e 38 Kutive të Votimit, ndërsa 44 ankesat tjerat janë refuzuar si të pabazuara dhe hedhur poshtë si të pasafatshme.

Rastet e pranuara në PZAP nga Votuesit Jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më 22 Tetor 2017

Gjatë procesit zgjedhor të mbajtur më 22 Tetor 2017, janë parashtruar 4 ankesa nga votuesit jashtë Kosovës. Natyra e ankesave të parashtruara ka qenë mospërfshirja e votuesve në listën përfundimtare të votuesve nga ana e KQZ-së, për Zgjedhjet Lokale të 22 Tetorit 2017.

Nr.	2017	
1	Parregullta	0
2	Të pasafatshme	0
3	Çështje gjykuar	0
4	Të Miratuara	2
5	Të Refuzuara	2
Totali		4

Numri ankesave të parashtruara në PZAP për Zgjedhjet Lokale të 22 Tetorit 2017

Gjatë procesit zgjedhor për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më 22 Tetor 2017, në PZAP janë parashtruar 1142 nga të gjitha palët e interesit, si nga subjektet politike, kandidatët, shoqëria civile, votuesit etj. të cilat janë të prezantuara në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Rastet e dorëzuara	2017
1	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	106
2	Aleanca Kosova e Re (AKR)	42
4	Alternativa	23
6	Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)	128
7	G.I. Lista Srpska	10
8	GI Lipjan Nasha Kuqa	2
9	GI Lipjan Narodna Slloga	5
10	GI SDP Oliver Ivanoviq	3
11	GI Gornje Kuse	2
14	Iniciativa Qytetare në Skenderaj	1
15	Iniciativa e Pavarur	1
16	Iniciativa Qytetare IQDU	2
